



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 387 Akti

Nr. 505 Vendimi
Tiranë, më 28.1.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 25.1.2022, në orën 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gentian Marku**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, aktualisht i komanduar edhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Gentian Marku, me detyrë aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Gentian Marku do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Gentian Marku, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 9.1.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në datat 24.1.2020 dhe 28.4.2020, sipas kërkesës së Komisionit ka rikonfirmuar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 15.12.2021, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Gentian Marku, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda 13 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 15.12.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 13 ditëve. Në datën 27.12.2021, subjekti paraqiti një kërkesë për shtyrje afati në referim të pikës 3, të nenit 53, të Kodit të Procedurave Administrative, prej 7 ditësh, me arsyetimin se për shkak të angazhimit të tij si gjyqtar në dy gjykata dhe pamundësisë për të siguruar informacionin e nevojshëm rrjedhojë e pushimeve për festat e fundit, nga gjykatat dhe institucione të ndryshme është bërë e pamundur marrja e informacionit nga ana e tij. Komisioni, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit përmes komunikimit *online*, çmoi të informojë subjektin se kërkesa e tij nuk gjendej e justifikuar sipas pikës 3, të nenit 53, të Kodit të Procedurave Administrative, pasi: (i) duke marrë në konsideratë barrën e provës në raport me 13 ditët që ishin vendosur që subjekti të paraqiste qëndrimin e tij, rezultonte se vetëm një ditë (data 27 dhjetor) ishte ditë pushimi; (ii) Komisioni ka administruar vërtetimin e angazhimit të subjektit në dy gjykata, por çmoi se kjo kërkesë rezultonte e

përsëritur dhe se ishte marrë parasysh gjatë hetimit; (iii) në referim të pretendimeve, me qëllim shtyrjen e afatit, nuk rezultonte të ishte paraqitur asnjë shkresë/kërkesë drejtuar ndonjë institucioni, për të provuar pamundësinë e marrjes së informacioneve në dobi të prapësimeve. Trupi gjykues, në diskrecionin e tij, në tërësi të kësaj çështjeje dhe çdo faze të ecurisë së saj, i kërkoi subjektit të depozitonte qëndrimin e tij dhe çdo dokumentacion tjetër, në çdo ditë zyrtare pune që nuk rezultonte festë zyrtare, deri në ditën e seancës dëgjimore, e cila ishte parashikuar që do të mbahej në datën 11.1.2022.

Subjekti, në datat 27.12.2021 dhe 29.12.2021, dërgoi në mënyrë elektronike shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Trupi gjykues, në datën 6.1.2022, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Gentian Marku, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke njoftuar në të njëjtën datë subjektin, se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 11.1.2021, në orën 12:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Në datën 7.1.2022, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin se ka rezultuar pozitiv me COVID-19, duke depozituar edhe vërtetimin përkatës të Qendrës Shëndetësore Lezhë. Në këto rrethana, Komisioni vendosi të shtyjë seancën dëgjimore, duke njoftuar subjektin e rivlerësimit se do të zhvillohej në datën 25.1.2022, në orën 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Gentian Marku u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gentian Marku. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 25.1.2022, për të rifilluar në datën 28.1.2022 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Gentian Marku ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit

nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 24.9.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Gjentian Marku, e cila ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në datën 24.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) argumentimet e dhëna verbalisht në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting sipas formularit* (shtojca nr. 2) të datës 24.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi, si vijon:

1. Pasuria e llojit “tokë arë”, me sip. 1.896 m², me nr. *, në fshatin P., Njësia Administrative B., Bashkia Lezhë.** Blerë në datën 19.5.2012 (me kontratë noteriale). Burimi i krijimit: kursime të familjes; emigracioni; dhe të ardhura nga pagat. Vlera: 485.376 lekë. Pjesa takuese: 50%.

¹Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

2. Pasuria e llojit “tokë arë”, me sip. 4275 m², me nr. ***, në fshatin P., Njësia Administrative B., Bashkia Lezhë. Kontratë noteriale blerjeje datë 19.5.2012. Burimi i krijimit: kursime të familjes; emigracioni; dhe të ardhura nga pagat. Vlera: 1.094.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

3. Pasuria e llojit “tokë arë”, me sip. 7783 m², me nr. ***, në fshatin P., Njësia Administrative B., Bashkia Lezhë. Kontratë noteriale blerjeje në datën 19.5.2012. Burimi i krijimit: kursime të familjes; emigracioni; dhe të ardhura nga pagat. Vlera: 1.992.448 lekë. Pjesa takuese: 50%. Për këto pasuri subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

3.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka bërë të njëjtin konstatim për këto pasuri pasi janë blerë me të njëjtën kontratë shitjeje²: deklaram i pasaktë lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e pasurive tokë arë me sip. 1.896 m², 4.275 m² dhe 7.783 m², pasi në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2014 është deklaruar “kursime të familjes, të ardhura nga paga”, ndërsa në deklaratën e pasurisë *Vetting* është deklaruar “kursime të familjes, emigracioni, të ardhura nga pagat”. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e familjes dhe emigracioni, që kanë shërbyer për blerjen e pasurive të mësipërme, në mënyrë respektive, në vlerat 485.376 lekë, 1.094.000 lekë dhe 1.992.448 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

3.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti i ka deklaruar këto pasuri për herë të parë në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2014, me përshkrimin:

- Tokë arë me sip. 1896 m², fshati P., Komuna B., Lezhë. Blerë më 19.5.2012 (kontratë noteriale). Burimi i krijimit: kursime të familjes dhe të ardhura nga pagat. Vlera: 485.376 lekë. Pjesa takuese: 50%.

- Tokë arë me sip. 4275 m², fshati P., Komuna B., Lezhë. Blerë më 19.5.2012 (kontratë noteriale). Burimi i krijimit: kursime të familjes dhe të ardhura nga pagat. Vlera: 1.094.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

- Tokë arë me sip. 7783 m², fshati P., Komuna B., Lezhë. Blerë më 19.5.2012 (kontratë noteriale). Burimi i krijimit: kursime të familjes dhe të ardhura nga pagat. Vlera: 1.992.448 lekë. Pjesa takuese: 50%.

3.3 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, kjo e fundit, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Lezhë³, ka konfirmuar se në emër të shtetasit Gentian L. Marku rezultojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme si vijojnë:

- pasuri e paluajtshme e llojit “arë”, me sipërfaqe totale 7.783 m², nr****, vol. ***, f. ***, z. k. ***, certifikuar nga ASHK-ja Lezhë datë 19.6.2012, në bazë të regjistrimit të kontratës së shitjes dhe me vendndodhje fshati P., Lezhë;

- pasuri e paluajtshme e llojit “arë”, me sipërfaqe totale 4.275 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, certifikuar nga ASHK-ja Lezhë datë 19.6.2012, në bazë të regjistrimit të kontratës së shitjes dhe me vendndodhje fshati P., Lezhë;

- pasuri e paluajtshme nr****, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “arë”, me sipërfaqe totale 1.896 m², certifikuar nga ASHK-ja Lezhë datë 19.6.2012, në bazë të regjistrimit të kontratës së shitjes dhe me vendndodhje fshati P., Lezhë.

²Kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.5.2012, me palë shitëse shtetasit L. dhe D.M. (prindërit e subjektit) dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit.

³Me shkresën nr. ***prot., datë 1.7.2020 në dosjen e Komisionit.

3.3.i Nga analizimi i dokumentacionit mbështetës të depozituar nga ky institucion, rezultoi se këto pasuri janë blerë nga subjekti i rivlerësimit me të njëjtën kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.5.2012, nga shtetasit L. dhe D. M. (prindërit e tij), sipas të njëjtave vlera të deklaruara edhe prej tij. Çmimi total i këtyre pasurive është në shumën 3.571.824 lekë.

3.3.ii Komisionit, nga hetimi, i rezultoi se këto pasuri janë shitur nga prindërit e subjektit, nga pasuria totale që ata kanë zotëruar. Këto pasuri, në një sipërfaqe totale prej 28.225 m², janë konfirmuar nëpërmjet aktit të marrjes së tokës⁴ në pronësi datë 15.5.1995. Nga kjo sipërfaqe totale, prindërit i kanë shitur subjektin të rivlerësimit, fëmijëve të tjerë, si dhe të tretëve.

3.4 Komisioni e ka pyetur⁵ subjektin lidhur me përfitimin e këtyre pasurive, si dhe për pjesët takuese të gjithsecilit prej anëtarëve të trungut familjar. Subjekti ka qartësuar se: *“Familja bujqësore përfaqësohet nga kryetari dhe kryetari i familjes bujqësore si përfaqësues i saj (në rastin konkret babai im) ka menaxhuar shitjet dhe ka administruar të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie në dobi edhe të anëtarëve të tjerë të familjes bujqësore.*

Sa i përket faktit se pjesë të këtyre pasurive janë tjetërsuar tek persona të tjerë apo tek ne fëmijët me kontrata të ndryshme, pa u bërë më parë pjesëtimi në natyrë i pjesëve takuese (pasi pjesët ideale janë ipso lege të përcaktuara nga mënyra e fitimit të pronësisë me ligjin nr. 7501), ky nuk përbën detyrim as kusht ligjor, pasi shitja e pjesëve ideale takuese është një veprim i lejuar ligjor, sikurse shitja e një pasurie pas pjesëtimit. Sa i përket faktit se këto pasuri nuk kanë figuruar të regjistruara në ZVRPP Lezhë në emër të të gjastë bashkëpronarëve, por në emër vetëm të babait si kryefamiljar, kjo ka qenë një praktikë rutinë e ZVRPP-ve në të gjithë vendin dhe rasti ynë nuk bën përjashtim. Gjithsesi, pavarësisht paraqitjes formale si shitës vetëm të prindërve dhe në ndonjë kontratë edhe timen, në thelb ne kemi qenë gjithmonë të vetëdijshëm për pjesët tona takuese dhe në çdo tjetërsim babai i ka ndarë çmimin e shitjes të gjithë bashkëpronarëve sipas pjesëve takuese (nga 1/6). Pra, megjithëse ne nuk kemi kryer pjesëtim paraprak të pjesëve në natyrë, për shkak të praktikave të gabuara të ZVRPP-së dhe të noterëve, si shitës figurojnë vetëm një pjesë e bashkëpronarëve (që në atë kohë ishin në trung familjar me prindërit), babai i ka ndarë gjithmonë të ardhurat nga çmimi i shitjes sipas pjesëve takuese të secilit (nga 1/6). Pra, për të gjitha kontratat e shitblerjeve të realizuara, në cilësinë e shitësit rezultojnë ata persona që kanë qenë në përbërjen familjare në kohën e kryerjes së veprimit juridik”.

3.5 Në tërësi, për këto pasuri, trupi gjykues, nisur nga fakti i vërtetuar prej dokumentacionit të ASHK-së, administruar në dosje, ku secili prej anëtarëve të familjes, aktualisht, rezultojnë të jenë titullarë të pronësisë për pjesën takuese, nuk konstatoi problematika lidhur me përfitimin e këtyre pasurive – tokë arë.

Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre pasurive

3.6 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi të këtyre pasurive: kursime të familjes; emigracionin; dhe të ardhura nga pagat. Ndërsa në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2014 subjekti ka deklaruar kursime të familjes dhe të ardhura nga pagat.

3.6.i Komisioni e ka pyetur⁶ subjektin lidhur me këtë mospërputhje dhe, njëkohësisht, i ka kërkuar edhe dokumentacionin për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga emigracioni.

⁴Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵Pyetësor nr. 4 datë 23.11.2021.

⁶Me pyetësorin nr. 2 datë 27.9.2021.

3.6.ii Subjekti, në përgjigjen e dhënë ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Me termin ‘kursime të familjes’ kam nënkuptuar jo vetëm një kategori kursimesh që burojnë nga puna në vendin tonë pas zbritjes së shpenzimeve, por çdolloj shume monetare që është kursyer nga çdolloj e ardhure e familjes, përfshirë punën time në emigrim, të ardhurat e krijuara nga kultivimi i tokës bujqësore, punën tonë si bashkëshortë në vendin tonë, të ardhurat nga shitja e pasurive dhe çdolloj të ardhure tjetër të ligjshme të familjes tonë”.*

3.7 Komisioni analizoi secilin burim krijimi, që ka shërbyer për blerjen e këtyre pasurive.

3.7.i Lidhur me të ardhurat nga emigracioni, subjekti ka sqaruar⁷ se: *“Në lidhje me dokumentacionin justifikues të të ardhurave nga puna ime në emigrim, sqaroj se: kam qenë emigrant në Itali gjatë periudhës gusht 1999 – tetor 2002. Gjatë kësaj periudhe kam punuar në punë të ndryshme në sektorin e ndërtimit, pa qenë i siguar, sepse nuk disponoja dokumentacion qëndrimi. Në vitin 2002 u miratua një ligj nga parlamenti italian, i quajtur ligji ‘Bossi – Fini’, sepse këta dy deputetë ishin propozuesit e ligjit. Ky ligj parashikonte, ndër të tjera, pajisjen me leje qëndrimi për të gjithë emigrantët e paligjshëm, por duke përmbushur disa kushte si: pasja e një shtëpie banimi, e një pune etj. Në rrethanat e sipërcituara, unë kam aplikuar për leje qëndrimi në Itali, sepse i përmbushja kriteret ligjore, ku themelore ishin: shtëpia dhe puna. Nga ana e autoriteteve italiane, në vitin 2002, më është lëshuar leja e qëndrimit për në shtetin italian, por që, aktualisht nuk e disponoj.*

*Në bazë të prokurës së posaçme nr. ***, datë 4.6.2020, kam autorizuar avokaten M. B., avokate në Itali, ndër të tjera, që të kërkojë dhe të tërheqë dokumentet përkatëse që vërtetojnë periudhën e sigurimit tim dhe punësimit, si dhe të ardhurat përkatëse pranë shoqërisë ‘***. Të tërheqë çdo lloj dokumentacioni që më përket mua pranë të gjitha organeve kompetente dhe t’i legalizojë ato pranë organeve kompetente duke përfshirë edhe vulën apostile. Të ardhurat e mësipërme paraqesin vetëm një pjesë fare të vogël të të ardhurave të mia nga emigracioni në Itali, pasi periudhën pararendëse, që nga gushti 1999 unë kam punuar pa siguracione, pasi nuk kam pasur leje qëndrimi dhe nga puna e ndershme tek i njëjti punëdhënës kam siguruar të ardhura të konsiderueshme, mesatarja 1.500 euro/muaj, rreth 18.000 euro/vit”.*

3.7.ii Lidhur me të ardhurat e familjes dhe të ardhurat nga pagat, subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues si me deklaratën *Vetting* ashtu edhe gjatë hetimit administrativ.

3.7.iii Subjekti është pyetur⁸ në lidhje me të ardhurat familjare për të identifikuar saktësisht burimin e krijimit të këtyre pasurive. Ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se janë të ardhurat e familjes së tij të re (subjekti dhe bashkëshortja), si dhe kontributi i tij në familjen e origjinës, i dhënë përpara martesës. Për rrjedhojë, në analizën financiare Komisioni ka përfshirë çdo të ardhur të dokumentuar ligjërisht të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

3.7.iv Arsyetimi mbi analizën financiare është bërë në tërësi, në pikën nr. 7.13, ku janë përfshirë të gjitha investimet e identifikuara.

3.8 Komisioni, në analizë të dokumentacionit të administruar për pasuritë tokë arë, konstatoi se dukej se: (i) kishte mospërputhje në burimin e krijimit të këtyre pasurive, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti kishte deklaruar si burim krijimi edhe të ardhurat nga emigracioni, ndërsa në DPV-në para fillimit të detyrës për vitin 2014 dhe në deklaratat periodike në vijim, nuk e kishte deklaruar këtë burim krijimi dhe se (ii) subjekti nuk provonte marrëdhënien e punësimit në Itali dhe, si pasojë, nuk provonte as të ardhurat e deklaruara për periudhën e emigracionit dhe, në këtë kuadër, iu kalua barra e provës⁹ për të dhënë argumentet në lidhje me këto konstatime.

⁷Me pyetësorin nr. 2 datë 27.9.2021.

⁸Pyetësor nr. 4 datë 23.11.2021.

⁹Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

3.9 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij¹⁰, ndër të tjera, për konstatimin lidhur me mospërputhjen në burimin e krijimit të këtyre pasurive, ka shpjeguar se: “... sikurse kam shpjeguar në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, burimi i deklaruar i krijimit të kësaj pasurie është i njëjtë, pasi kursimet nga puna në emigracion janë pjesë përbërëse e kursimeve familjare, sikurse janë kursimet nga puna brenda vendit (të cilat as ato nuk i kam deklaruar në mënyrë specifike duke i detajuar), apo çdo veprimtari tjetër e ligjshme e familjes time nga e cila janë gjeneruar të ardhura. Pra në deklaratën Vetting thjesht është shtuar si sqarim ky zë i veçantë i kursimeve familjare, pa i ndryshuar asgjë vlerës kuptimore të burimit të deklaruar të krijimit të kësaj pasurie. Pra, edhe sikur e kam deklaruar edhe sikur mos ta deklaroja në këtë mënyrë në deklaratën Vetting, sërish çdolloj pune dhe aktiviteti i ligjshëm nga i cili kam realizuar të ardhura dhe kam arritur që të kursej të holla përfshihet brenda nocionit ‘kursime familjare’ (sikurse Komisioni ka njohur të ardhurat nga puna ime apo e bashkëshortes sime). Për rrjedhojë, vlerësoj se kjo barrë prove është thjeshtë një interpretim gjuhësor i konceptit të kursimeve familjare”.

3.9.i Për konstatimin lidhur me faktin se subjekti nuk provonte marrëdhënien e punësimit në Itali dhe, si pasojë, nuk provonte as të ardhurat e deklaruara për periudhën e emigracionit, subjekti ka shpjeguar se: “Në lidhje me këtë barrë prove ripërsëris se emigrimi im në Itali në muajin gusht 1999 ka qenë me gomone si pjesa dërrmuese e bashkatdhetarëve tanë dhe shumicën e qëndrimit në këtë vend unë kam qenë pa dokumente të rregullta qëndrimi. Pra, megjithëse unë kam punuar gjatë gjithë kohës së qëndrimit në këtë vend deri në tetor të vitit 2002, unë kam arritur që të pajisem me leje qëndrimi në muajin shtator 2002 dhe kam punuar si i siguruar që nga muaji qershor 2002. Për këtë periudhë kam paraqitur pranë jush nga INPS një dokument që provon këtë periudhë sigurimi dhe të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Duke qenë se ky dokument ka dalë nga një akses online, pa vulë të këtij institucioni ka qenë e pamundur pajisja e tij me vulë apostile”.

3.9.ii Në vijim, subjekti i ka qëndruar pretendimeve të paraqitura edhe në pyetësorin nr. 2 lidhur me autorizimin për avokaten M.B., në Itali. Ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se: “Më është vënë në dispozicion një dokument elektronik i lëshuar nga INPS ose Instituti Italian i Sigurimeve Shoqërore, ku rezultojnë 24 javë periudhë sigurimi, me të ardhura neto 4.376 euro. Pavarësisht korrespondencës që kam pasur me avokaten, nuk kam arritur që ta siguroj dokumentin në formën e duhur ligjore (me vulë apostile)”. Në vijim të përpjekjeve për të siguruar dokumentacion, subjekti ka deklaruar se: “Para rreth 2 muajsh kam kontaktuar me një kushërirën time që jeton dhe punon në Itali, duke i kërkuar asaj që të interesohet në lidhje me periudhën time të sigurimit. Gjithashtu, me anë të një deklaratë me shkrim, i kam dhënë të drejtë asaj që të marrë informacion pranë zyrës së Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore në vendqëndrimin tim të asaj kohe, në qytetin Bra, Provinca Cuneo. Gjithashtu i kam dhënë të drejtë që të interesohet edhe pranë punëdhënësit tim. Nga ana e saj më është bërë e ditur se ka pasur një takim në zyrën e sipërcituar dhe se do t’i kthejnë përgjigje zyrtarisht. Vioj përpjekjet për të marrë një vërtetim të tillë, megjithëse siç kam shpjeguar të ardhurat nga puna për të cilat kam paguar kontributet përbën një fraksion të vogël të të ardhurave të ligjshme që unë kam siguruar në këtë vend (rreth 16.000 – 18.000 euro/vit, apo rreth 51.000 euro në total)”.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

3.10 Trupi gjyqësor, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve të tij

¹⁰Datë 29.12.2021.

në prapësime, por edhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

3.10.i. Në lidhje me konstatimin e mospërputhjes së burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti kishte deklaruar edhe të ardhurat nga emigracioni, ndërsa në DPV-n-në para fillimit të detyrës për vitin 2014 dhe në deklaratat periodike në vijim nuk e kishte deklaruar këtë burim krijimi, trupi gjykues, duke vlerësuar shpjegimin e subjektit mbi logjikën e tij se çfarë ka përfaqësuar nocioni “*kursime familjare*”, në deklarin e tij para fillimit të detyrës, e konsideron të pranueshëm shpjegimin e tij se në *kursimet familjare* të deklaruara si burim për këto pasuri ka përfshirë çdo të ardhur të përfituar nga familja e tij, përfshirë këtu edhe ato të përfituara nga emigracioni. Në këtë drejtim, trupi gjykues nuk evidenton ndonjë problematikë në nivel pasaktësie, për sa kohë subjekti ka deklaruar burimet e krijimit të pasurive “tokë arë” në deklaratën *Vetting*, si pikënisje për procesin e rivlerësimit, deklaratë e cila sipas ligjit nr. 84/2016 duhej plotësuar në mënyrë të detajuar dhe të plotë.

3.10.ii. Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre pasurive, trupi gjykues, nisur nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga (a) punësimi i subjektit dhe bashkëshortja e tij, si dhe (b) kursimet e krijuara prej tyre, në raport me pretendimin e tij, për mosllogaritje të plotë të të ardhurave nga punësimi i tij dhe bashkëshortes, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, ka rivlerësuar këto përllogaritje duke analizuar provat e administruara, të cilat kanë provuar faktet e renditura në vijim:

Nga verifikimi i statementit bankar në “Raiffeisen Bank”, për periudhën korrik 2010 – tetor 2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga punësimi në vlerën 2.125.021 lekë dhe 793.314 lekë nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 21.2.2012. Pra, në total ka përfituar vlerën 2.918.335 lekë. Ndërsa bashkëshortja e subjektit, nga verifikimi i statementit bankar në “ProCredit Bank”, për të njëjtën periudhë ka përfituar nga punësimi shumë 1.993.940 lekë. Marrëdhënia e punësimit për secilin nga bashkëshortët provohet edhe me vërtetimet përkatëse nga punëdhënësit¹¹. Këto të ardhura, në kushtet që plotësojnë kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, janë përllogaritur në analizën financiare.

3.10.iii. Ndërsa, sa i përket deklarinimit të subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e krijuara nga emigracioni, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit se ka punuar në shtetin italian në periudhën 1999 – 2002 konfirmohen nga vetë subjekti se ka përfituar të ardhura, për të cilat kryesisht nuk ka qenë i siguruar, pasi ka qenë pa dokumente qëndrimi.

3.10.iv. Në këtë drejtim, trupi gjykues, ndodhur përpara fakteve të tilla si: (a) punësimi i subjektit, sipas pretendimit të tij, në emigrim ka ndodhur në kushtet dhe rrethanat që kanë diktuar vendin në tranzicion; (b) dokumentacioni i depozituar prej tij për shumë e përfituar në vlerën 4.376 euro, shërben si *indicie* për punësimin e tij në shtetin italian, vlerëson se pavarësisht se legjitimiteti i kësaj shume në raport me shpenzimet e jetesës në shtetin italian nuk është i mjaftueshëm për të krijuar kursimet e pretenduara nga subjekti, kjo *indicie* (në nivelin e një prove indirekte) ka një peshë në drejtim të besueshmërisë së punësimit të tij në shtetin italian.

3.10.v. Mbi impaktin e të ardhurave të ligjshme në rezultatin financiar, mbi mundësinë¹² e blerjes së këtyre pasurive dhe të gjitha investimeve të tjera të kryera nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, i gjendur në rrethanat se: (a) burime të njëjta janë përdorur edhe në investime të tjera, të cilat kanë datuar përpara fillimit të detyrës; (b) këto të ardhura të pretenduara datojnë përpara blerjes së pasurisë së paluajtshme “apartament” në vitin 2010, e cila arsyetohet në vijim

¹¹Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë; vërtetim nr*** prot., datë 25.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga DAR Lezhë.

¹²Nuk u morën në konsideratë të ardhurat nga emigracioni.

në këtë vendimmarrje në pikën nr. 7, duke mos konstatuar problematika mbi mënyrën e përfitimit të tyre, përlllogaritjet financiare për blerjen e tokave, si dhe kryerjen e investimeve të tjera para fillimit të detyrës për periudhën 2010 – 2014, vlerësoi t'i trajtojë së bashku duke i pasqyruar/arsyetuar po në pikën 7, të vendimmarrjes.

4. Pasuria tokë truall me sip. 300 m² dhe pemëtore me sip. 180 m², nr. ***, fshati P., Njësia Administrative B., Bashkia Lezhë. Pasuria është e regjistruar në regjistrin e ZVRPP-së Lezhë në emër të babait, L. M., me datë 10.2.2016. Është pasuri familjare. Burimi i krijimit: fituar në bazë të VKM-së nr. 266, datë 8.8.1991, “Për ndarjen e pasurisë në kooperativat bujqësore”. Pjesa takuese: 1/6 ose 16.66 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

4.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: “Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Lezhë”.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

4.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave private për vitin 2015, me përshkrimin “tokë truall me sip. 300 m² dhe pemëtore 180 m², fshati P., Komuna B., Lezhë. Është e regjistruar në regjistrin e ZVRPP-së Lezhë, në emër të babait, L.M. . Është pasuri familjare. Burimi i krijimit: fituar në bazë të VKM-së nr. 266, datë 8.8.1991, “Për ndarjen e pasurisë në kooperativat bujqësore”. Subjekti zotëron 1/6 ose 16.6 %”.

4.3 ASHK-ja¹³ ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “truall” me sip. 300 m², nga të cilat ndërtesë 160 m², certifikuar nga ASHK-ja Lezhë, më 11.2.2016, në bazë të regjistrimit të dokumentacionit të ndarjes së pasurisë së paluajtshme, me vendndodhje fshati P., Lezhë.

4.4. Komisioni, në analizë të dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja¹⁴, referuar e-mail-it zyrtar nga ZVRPP-ja Lezhë (datë 24.9.2018), ka konstatuar se pasuria nr. ***, tokë truall me sip. 300 m², vol. ***, f. ***, ka kaluar në pronësi të shtetasit L. M. me sip. 300 m² truall, mbi të cilin ndodhet 161 m² ndërtesë, ndërsa pjesa tjetër pemëtore me sip. 180 m² ka kaluar në pronësinë shtet. Gjithashtu, në raportin e ILDKPKI-së, parashikohet se në momentin e aplikimit për certifikatë pronësie z. L. M. ka dorëzuar plan rilevimi për ndarje të pasurisë, pasi ka pasur të regjistruar sipërfaqe më shumë se çfarë i takon sipas listës së trojeve.

4.5 Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar edhe pjesën e tij takuese në pasurinë me sip. 180 m² (pemëtore), ndërsa në fakt kjo e fundit rezultonte në favor të shtetit.

4.6. Subjekti është pyetur¹⁵ lidhur me këtë konstatim, i cili në përgjigjen e dhënë, ka deklaruar se: *“Në lidhje me këtë pronë saktësoj se ajo është përfituar në bazë të VKM-së nr. 432, datë 14.8.1995, ‘Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit’. Në kohën e deklaramit të kësaj pasurie, qoftë në deklaratën periodike vjetore 2015, qoftë në deklaratën Vetting, i jam referuar dokumentit që administrohet nga ish ZVRPP-ja Lezhë, sot ASHK Drejtoria Vendore Lezhë, nën titullin ‘lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive’ për zonën kadastrale ***, fshati P., ku në numrin rendor 28 rezulton pasuria nr. ***, pemëtore 180 m², truall 300 m², nga kjo, 161 m² ndërtesë”.*

Bashkëngjitur përgjigjes, subjekti ka paraqitur si provë listën e plotë për fshatin P., të marrë nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Lezhë.

¹³Me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2020, në dosjen e Komisionit.

¹⁴Aneksi nr. 28 i dosjes së ILDKPKI-së.

¹⁵Me pyetësin nr. 3, datë 9.11.2021.

Subjekti shprehet se: “Sa i përket korrespondencës së mbajtur nga ILDKPKI-ja me ZVRPP-në Lezhë, ku sipas jush, konfirmohet se sipërfaqja prej 180 m² pemëtore ka kaluar në pronësi të shtetit, unë nuk kam pasur dijeni, pasi nuk jetoj në fshatin P., por pas pyetjes suaj dhe interesimit tim pranë ASHK-së Drejtoria Vendore Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2021 (të cilën po e paraqes si provë) kam mësuar se me anë të aplikimit nr. ***, datë 12.11.2015, babai im ka aplikuar për ndarjen e pasurisë së paluajtshme me nr***, zonë kadastrale ***, e llojit pemëtore + truall, me sipërfaqe totale 480 m², nga të cilat 300 m² truall dhe 161 m² ndërtesë, duke bërë ndarjen dhe krijuar 2 pasuri të paluajtshme bija si:

a) Pasuria e paluajtshme me nr. ***, z. k. ***, regjistruar në volumin ***, faqe ***, e llojit truall, me sipërfaqe totale 300 m², nga të cilat 161 m² ndërtesë, certifikuar nga ish ZVRPP-ja Lezhë më 11.2.2016, në emër të z. L. Z. M. .

b) Pasuria e paluajtshme me nr. ***, z. k. ***, regjistruar në volumin ***, faqe ***, e llojit pemëtore, me sipërfaqe totale 180 m², regjistruar shtet.

Me anë të këtij aplikimi është bërë regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme vetëm e sipërfaqes së truallit dhe e banesës, ndërkohë që nuk është bërë regjistrimi i sipërfaqes prej 180 m² pemëtore, që ka vijuar formalisht që të figurojë në regjistrat e pasurive të paluajtshme si pasuri në pronësi shtet. Në këtë këndvështrim, duhet sqaruar se sipërfaqja prej 180 m² e zërit kadastral ‘pemëtore’, nuk është se ka kaluar në vitin 2015 nga pronësia private në emër të babait tim, në pronësi shtet, pasi ajo shtet figuronte edhe më parë në regjistrat e pasurive të paluajtshme (sipas rregullit që çdo pasuri që nuk është e regjistruar në emër të subjekteve të ndryshme private është pasuri shtet). Ndryshimi i vetëm që ka ndodhur në vitin 2015 ka qenë se e gjithë kjo pronë me dy zëra të ndryshëm kadastral (njëri truall dhe tjetri pemëtore, që në fakt është oborr i shtëpisë) është ndarë në dy prona të reja dhe është bërë regjistrimi fillestar (pra, duke kaluar nga shtet në privat) vetëm për sipërfaqen e truallit dhe banesës brenda saj.

Duke marrë në konsideratë se pronar mbi një pasuri të paluajtshme nuk të bën regjistrimi i kësaj prone në regjistrat e pasurive të paluajtshme, por titulli i pronësisë dhe nisur nga qëllimi im i mirë për të qenë plotësisht transparent dhe i hapur me institucionet e deklaramentit dhe kontrollit të pasurive dhe, më tej, ato të rivlerësimit kalimtar, unë e kam deklaruar këtë pasuri siç figuron në listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive.

Në vijim për të sqaruar këtë situatë, në datën 14.11.2021 kam kërkuar një informacion zyrtar në lidhje me gjetjet e Komisionit, për të sqaruar situatën juridike të pasurisë së paluajtshme të llojit ‘pemëtore’.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2021, më ka kthyer përgjigje zyrtare duke më informuar, ndër të tjera, se titullari i të drejtës së pronësisë me nr. ***, z. k. ***, z. L. Z. M. mund të aplikojë për procedurën e miratimit të dokumentit të pronësisë për pasurinë e paluajtshme me nr. ***, z. k. ***, nëpërmjet platformës qeveritare e-albania dhe të shlyejë tarifën e shërbimit për procedurën administrative.

Gjithsesi, pasi jam vënë në dijeni të këtyre fakteve, babai im, më 17.11.2021 ka aplikuar për regjistrimin edhe të pasurisë së paluajtshme me nr. *** e llojit ‘pemëtore’, me sipërfaqe totale 180 m² dhe bashkëngjitur kësaj përgjigjeje po paraqes si provë aplikimin e bërë prej tij”.

4.6.i Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna, subjekti ka depozituar: (i) shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2021, nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Lezhë; (ii) kërkesën nr. *** prot., datë 17.11.2021, për kalimin e pronësisë të objektit pa titull, truallit funksional, oborrit në përdorim, kryer nga babai i subjektit, shtetasi L. Z. M., në ASHK-në Drejtoria Vendore Lezhë; (iii) certifikatën për vërtetim pronësie me nr***, për pasurinë me nr*** (truall me sip. 300 m², nga të cilat ndërtesë 160 m²), lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në datën

11.2.2016, shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë, njehsuar me origjinalin me vërtetimin noterial nr. *** rep., datë 11.11.2021.

4.7 Komisioni, në analizë të këtij dokumentacioni, konstatoi se ASHK-ja Drejtoria Vendore Lezhë, në përgjigjen e saj e ka informuar shtetasin L.Z. M. (babai i subjektit) *se mund të aplikojë për procedurën e miratimit të dokumentit të pronësisë për pasurinë e paluajtshme me nr. ***; z. k. ***; nëpërmjet platformës qeveritare e-albania dhe të shlyejë tarifën e shërbimit për procedurën administrative.*

4.8 Për sa më sipër, trupi gjykues pas këtij hetimi të thelluar për të qartësuar këtë çështje, konkludon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar, shpjegimet e dhëna nga subjekti, si dhe me veprimet e ndërmarra nga babai i tij për regjistrimin e pasurisë. Në këto kushte, në tërësi të fakteve dhe rrethanave të rezultuara, trupi gjykues nuk konstatoi problematika lidhur me këtë pasuri.

5. Automjet tip “Peugeot 306”, me kontratë noteriale shitjeje nr. ***, datë 12.4.2016. Vlera: 200.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

5.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

5.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2014 me përshkrimin: *“Automjet tip ‘Peugeot’, prodhim i vitit 2000, me targa AA ***, blerë më 15.3.2014 (kontratë noteriale). Vlera: 140.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kursime të familjes dhe të ardhura nga pagat”*.

5.3 Gjithashtu, Komisionit i rezultoi se në deklaratën periodike të vitit 2016 subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti.

5.4 DPSHTRR-ja¹⁶, pas verifikimeve të bëra në regjistrin elektronik kombëtar të automjeteve, ka konfirmuar se ky automjet ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe, për këtë, ka depozituar kontratat përkatëse të blerjes dhe shitjes së kësaj pasurie, të cilat rezultuan se janë të njëjta me ato që ka depozituar edhe subjekti. Rezultoi se ky automjet është shitur nëpërmjet kontratës së shitjes nr***, datë 12.4.2016, në vlerën 200.000 lekë.

5.5 Pavarësisht deklaramit në deklaratën *Vetting*, Komisioni ka evidentuar faktin se kjo është një pasuri të cilën subjekti i rivlerësimit nuk e disponon më dhe është blerë para fillimit të detyrës. Por, Komisioni, në kuadër të një hetimi sa më të plotë, hetoi gjithashtu edhe për përfitimin e kësaj pasurie.

5.5.i Nga hetimi ka rezultuar se ky automjet është blerë me kontratën nr. ***, datë 15.3.2014, me palë shitëse A.N. dhe palë blerëse Gentian Marku, në shumën 140.000 lekë. Në kontratë parashikohet se: *“Me marrëveshje të përbashkët të palëve, çmimi është caktuar të jetë 140.000 lekë, shumë të cilën blerësi e ka likuiduar tërësisht para përpilimit të kësaj kontrate shitblerjeje, jashtë kësaj zyre”*.

5.5.ii Subjekti ka deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2014 se burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer kursime të familjes dhe të ardhura nga pagat. Meqenëse deklarimi i parë i subjektit fillon në tetor të vitit 2014, Komisioni nuk mund të përcaktojë saktësisht se sa mund të kenë qenë kursimet familjare përpara blerjes së automjetit. Duke qenë se shuma e investimit nuk është në një vlerë të konsiderueshme,

¹⁶Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 13.5.2020, në dosjen e Komisionit.

Komisioni kreu analizën financiare për gjithë vitin 2014 për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit për të investuar dhe përballuar shpenzimet familjare gjatë këtij viti.

5.6 Për sa më sipër, trupit gjykues i rezultoi se deklarimi i subjektit përputhej me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja për shitjen e këtij automjeti. Ndërsa sa i përket analizës financiare, trupit gjykues i rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

6. Automjet tip “Volkswagen Touran”, viti 2005, blerë në datën 14.4.2016. Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e automjetit tip “Peugeot” dhe të ardhurat e kursyera në llogarinë e bashkëshortes. Vlera: 282.720 lekë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

6.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja”.*

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

6.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2016 me përshkrimin: *“Blerë në datën 14.4.2016, automjet tip ‘Volkswagen Touran’, viti 2005. Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e automjetit tip ‘Peugeot’ dhe të ardhurat e kursyera në llogarinë e bashkëshortes. Vlera: 282.720 lekë. Pjesa takuese: 50%”.*

6.3 DPSHTRR-ja¹⁷ ka konfirmuar se automjeti me targa AA *** është në pronësi të subjektit të rivlerësimit, i cili është blerë nëpërmjet faturës tatimore nr. ***, datë 14.4.2016, me palë shitëse Sh. M. dhe palë blerëse Gentian Marku, në vlerën 282.720 lekë.

6.4 Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Peugeot” dhe të ardhurat e kursyera në llogarinë e bashkëshortes. Shitja e automjetit tip “Peugeot” është analizuar në pikën nr. 5 të vendimit, nga ku rezultoi se ky automjet është shitur në datën 12.4.2016, pra përpara blerjes së automjetit tip “Volkswagen Touran”. Gjithashtu, nga hetimi rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka tërhequr nga llogaria e saj bankare në “ProCredit Bank” shumën 368.000 lekë, datë 13.4.2016, një ditë përpara blerjes së automjetit tip “Volkswagen Touran”.

6.5 Komisioni kreu analizën financiare në datën e investimit.

6.6 Nga analiza financiare, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

7. Apartament banimi¹⁸ me sip. 69,05 m², nr. *, z. k. ***, Lezhë, i shitur me kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.9.2016, pasuri bashkëshortore.** Shuma e të ardhurave *neto* është 3.100.000 lekë, e cila është transferuar në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes D. M., në “Intesa Sanpaolo Bank”, Lezhë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

7.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se:

i) Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e prindërve dhe motrës së bashkëshortes, të cilët i kanë dhënë hua subjektit shumat 1.200.000 lekë dhe 5.000 euro, shuma të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit të banimit me sip. 69.05 m².

¹⁷Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 13.5.2020, në dosjen e Komisionit.

¹⁸E krijuar prej vitit 2010, përpara fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit.

ii) Është e paqartë nëse huaja është marrë në vitin 2010, kur u ble fillimisht apartamenti apo në vitin 2012, kur u riblë përsëri, gjithashtu referuar kontratës së datës 13.7.2010, shuma totale për blerjen e apartamentit në shumën 3.605.000 lekë është likuiduar jashtë zyrës noteriale, ndërsa është e paqartë shuma që është tërhequr nga depozita dhe data e tërheqjes së saj nga shtetasi G. Gj. .

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

7.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti e ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2016, me përshkrimin: “Kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.9.2016, lloji i pasurisë së paluajtshme apartament banimi nr. ***, sipërfaqe 69.05 m², z. k. ***, Lezhë, pasuri bashkëshortore. Shuma e të ardhurave 3.100.000 lekë”.

7.3 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, kjo e fundit, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Lezhë¹⁹, ka informuar se janë dy zona kadastrale të pa hedhura në sistem për mungesë të regjistrimit fillestar, përkatësisht z. k. *** pjesërisht qyteti i Lezhës, si dhe *** qyteti i Shëngjinit. Në z. k. *** gjendet edhe pasuria e tjetërsuar nga subjekti.

7.4 Gjatë hetimit, Ministria e Drejtësisë²⁰ e ka informuar Komisionin për veprimet noteriale, ku nga Regjistri Noterial u identifikuan kontratat e lidhura nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij, si dhe të dhënat për të njëjtën kontratë të depozituar edhe nga subjekti i rivlerësimit për shitjen e pasurisë apartament.

7.5 Komisionit, nga hetimi, i ka rezultuar se vlera e shitjes së këtij apartamenti ka kaluar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”²¹, datë 13.10.2016. Ky transaksion është kryer nga llogaria e noterit publik Xh. P. person fizik me përshkrimin “likuidim kontrate nr. ***, datë 29.9.2016”.

7.6 Komisionit i rezultoi se deklarimi i subjektit përputhej me dokumentacionin e administruar për shitjen e kësaj pasurie.

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.7 Në analizë të dokumentacionit të administruar²², Komisioni konstatoi se kjo pasuri është blerë dhe shitur disa herë nga subjekti. Më konkretisht, pasuria është blerë për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme apartament banimi nr. ***, datë 13.7.2010, me sip. 69.05m², në vlerën 3.605.000 lekë, me palë shitëse N. Gj. . Në vijim, me kontratën e shitblerjes (pasuri e paluajtshme apartament) nr. ***, datë 7.2.2011, subjekti Gentian Marku ia ka shitur këtë pasuri shtetasit J. M. me po të njëjtën vlerë që e kishte blerë (3.605.000 lekë).

Më pas, me kontratën e shitblerjes (pasuri e paluajtshme apartament) nr. ***, datë 26.1.2012, shtetasi J.M. (i cili kishte vetëm 11 muaj që e kishte blerë këtë pasuri) ia shiti këtë pasuri me sip. 69.05 m², me vlerën 3.670.007 lekë, subjektit Gentian Marku. Në përfundim, subjekti e ka shitur këtë pasuri me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.9.2016, me palë blerëse shtetasin A. P., në vlerën 3.100.000 lekë.

7.8 Për shkak të blerje/shitjeve të shpeshta të këtij apartamenti, subjekti është pyetur²³ në lidhje me tjetërsimin e kësaj pasurie shtetasit J. M., në dy raste brenda një periudhe të shkurtër, për marrëdhënien që ka pasur apo ka me këtë shtetas, si dhe për mënyrën se si e ka disponuar këtë pasuri (në çfarë marrëdhënie kontraktore) për kohën që nuk ishte titullar i saj.

¹⁹Shkresë nr. ***prot., datë 1.7.2020.

²⁰Shkresë nr. ***prot., datë 8.5.2020.

²¹Shkresë nr. ***prot., datë 11.5.2020.

²²Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

²³Pyetësor nr. 3, datë 9.11.2021.

7.8.i Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ka sqaruar se shtetasin J. M. e ka fis nga babai, kushëri të dytë, ekzaktësisht gjyshërit nga babai kanë qenë vëllezër. Gjithashtu, ndër të tjera, ka shpjeguar gjendjen fizike të apartamentit, i cili ka pasur cilësi të dobët punimesh, probleme teknike apo menaxhimi, si dhe vështirësi të jetesës së tyre në këtë apartament duke qenë se familja e subjektit përbëhej nga dy fëmijë të vegjël dhe apartamenti ndodhej në katin e gjashtë, pa ashensor. Në vijim, subjekti ka deklaruar: *“Gjatë bisedave me të afërm, biseduam me kushëririn tim J. M., i cili ishte i interesuar që të blinte një apartament në qytetin e Lezhës për njërin nga djemtë e tij (pasi vetë J. e kishte banesën e tij në fshatin P.), me qëllim që të paktën njëri prej dy djemve të mos shkonte në emigracion. Në këtë mënyrë, ky shtetas ra dakord që ta blinte nga unë këtë apartament me të njëjtin çmim me të cilin unë vetë e kisha blerë 7 muaj më parë. Duke qenë se unë nuk kisha një banesë tjetër për t’u strehuar dhe blerësi apo familjarët e tij nuk kishin një plan të ngutshëm për t’u vendosur me banim në atë apartament (pasi vetë J. me djalin e madh jetonin në Greqi, ndërkohë që bashkëshortja me djalin tjetër jetonin në banesën e tyre private në fshatin P.), i kërkova që të më lejonte një periudhë disamujore që të vijoja të banoja në këtë apartament deri sa të gjeja një banesë tjetër dhe J. më premtoi se mund të rrija pa qira deri për vit të ri dhe më pas duhet t’ia liroja apartamentin. Me sa kujtoj, J. erdhi fillimisht në verë nga Greqia dhe shfaqti disa pakënaqësi të vogla për apartamentin, por kur u kthye sërish për festat e nëntorit dhe erdhi tashmë bashkë me bashkëshorten e tij, vunë re se ashensori nuk punonte, ndriçimi i shkallëve ishte i pjesshëm dhe ambientet e përbashkëta të papastruara dhe kur hynë në banesë, vërejtën se tavani i dy dhomave kishte shenja të dukshme lagështire. Të shqetësuar për këtë, më thanë se duhet të komunikonin me fëmijët dhe me persona që bëjnë riparimin e problemeve të tilla, përndryshe ata këtë apartament nuk mund ta mbanin. Pas interesimit të tij, profesionistë të kësaj fushe i kishin thënë se riparimi i tarracës për izolim të lagështirës kushtonte në një vlerë të konsiderueshme dhe, për më tepër, nuk mund të kryhej teknikisht në mënyrë të kënaqshme vetëm për një apartament, por duhej bërë një investim strukturor në tërësi për të gjithë pallatin (zgjidhje e pamundur për të gjetur konsensus në realitetin e banorëve të atij pallati, ku një pjesë e madhe jetonin jashtë vendit dhe banorët e kateve të poshtme shfaqnin indiferencë qoftë për tarracën, qoftë për ndriçimin e shkallëve, qoftë për ashensorin). Duke qenë se fëmijët i kishin shfaqur pakënaqësi dhe vërejtje për gjendjen e kësaj prone, para vitit të ri blerësi J. M. më shfaqti përfundimisht zhgënjimin e tij nga blerja që kishte bërë, duke këmbëngulur për kthimin e çmimit të blerjes mbrapsht, pasi i kishte shkaktuar konflikte familjare. Duke mos dashur që të hyja nëpër debate familjare e shoqërore dhe procedura gjyqësore dhe nisur edhe nga lidhjet e gjakut me të, vendosëm që ta prananim kërkesën e tij për rikthimin e marrëdhënies në gjendjen e mëparshme. Duke qenë se nga pikëpamja juridike dhe praktike nuk kishim asnjë rrugë tjetër më të thjeshtë për rikthimin e palëve në gjendjen e mëparshme (pasi rruga e vetme alternative ishte përmes një procesi gjyqësor për zgjidhjen e kontratës së lidhur), vendosëm që ta bënim përmes një kontrate të re blerjeje nga ana ime. Sa i përket çmimit të (ri) blerjes nga ana ime, që është në vlerën 65.007 lekë më e lartë se e shitjes nga unë më parë (shitur nga unë për çmimin 3.605.000 lekë dhe riblerë për çmimin 3.670.007 lekë), kjo u bë për dy lloj arsyesh. Së pari, pasi çmimi i (ri)blerjes prej meje në vlerën 3.670.007 lekë ishte tashmë (me ndryshimin e referencave shtetërore të çmimeve) çmimi minimal i lejueshëm për t’u shitur/blerë para noterit dhe nuk lejohej nga ligji lidhja e një kontrate shitjeje nën këtë çmim (pra as me të njëjtin çmim si ai i shitjes së bërë nga unë në muajin shkurt 2011). Së dyti, kjo rritje e lehtë çmimi kërkohet nga J. së paku për të mbuluar shpenzimet e tij noteriale dhe ato të udhëtimit nga Greqia (neni 742 i Kodit Civil), si dhe përmendi faktin se nga data e shitjes nga unë deri në datën e riblerjes ai kishte paguar çmimin e banesës së plotë dhe unë kisha vijuar të banoj në këtë banesë pa qira, ndërkohë pretendonte se edhe mund të kishte fituar interesa bankare nga kjo shumë. Gjendja e keqe e këtij apartamenti dhe e të gjithë këtij pallati dhe vështirësitë për shitjen e saj provohen qartë nga fakti se unë kam arritur që ta (ri)shes këtë apartament vetëm në vitin 2016 dhe vetëm për*

çmimin prej 3.100.000 lekësh (pra, 570.007 lekë më lirë nga sa e kisha riblerë, ndërkohë që çmimet e banesave në përgjithësi janë rritur gjatë këtyre viteve). Madje, me aq informacion sa kam, edhe blerësi i ri i saj A. P. nuk e ka përdorur këtë apartament pas blerjes, pasi banon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe me sa di nuk e ka dhënë as me qira”.

7.9 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar lidhur me transaksionet e kryera mbi këtë pasuri, fakteve dhe rrethanave të konkluduara përgjatë hetimit, si dhe shpjegimeve bindëse të dhëna nga subjekti lidhur me të gjitha veprimet e ndërsjella të kryera me vullnetin e lirë mes palëve, nuk konstatoi ndonjë problematikë sa i përket përfitimit të të ardhurave nga tjetërsimi i kësaj pasurie.

Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë

7.10 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, viti 2014, me përshkrimin: “Apartament banimi, sip. 69.05 m², rruga ‘***’, Lezhë. Blerë më 26.1.2012. Burim krijimi: kursime të familjes; të ardhura nga pagat 1.700.000 lekë; hua nga prindërit e bashkëshortes 1.200.000 lekë; dhe hua nga motra e bashkëshortes 5.000 euro. Vlera: 3.670.007 lekë”.

7.11 Meqenëse kjo pasuri e ka zanafillën prej vitit 2010, Komisioni e pyeti²⁴ subjektin për burimin e ligjshëm të krijimit në këtë vit. Subjekti ka sqaruar se për apartamentin e blerë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 13.7.2010, në çmimin 3.605.000 lekë kanë shërbyer si burim krijimi: (i) kursimet e tij dhe të familjes ndër vite në vlerën 1.700.000 lekë; (ii) hua nga prindërit e bashkëshortes në vlerën 1.240.000 lekë; si dhe (iii) hua nga motra e bashkëshortes në shumën 5.000 euro²⁵. Subjekti, përgjigjen e tij për secilin burim krijimi, e ka shoqëruar me dokumentacion justifikues.

7.11.i Në lidhje me kursimet familjare në vlerën 1.700.000 lekë

a) Komisioni konstatoi se subjekti ka depozituar dokumentacion për të provuar të ardhurat e përfituara nga punësimi i tij, i babait, i nënës dhe bashkëshortes. Vërtetimet e punësimit të tij i ka depozituar edhe në ILDKPKI, ndërsa për prindërit ka depozituar vërtetim për bazën e vlerësuar nga Njësia Administrative B., Shëndetësia, për vitet 2006 dhe 2007, për nënën e tij shtetasen D. M., si dhe vërtetim për bazën e vlerësuar nga Njësia Administrative B., shkolla 9-vjeçare + DAR për vitet 2006 – 2008, për babain L. M. . Për të ardhurat e bashkëshortes ka depozituar statement bankar nga “ProCredit Bank” dhe “Credins Bank”, dy llogaritë në të cilat i është kredituar paga si mësuese. Subjekti ka pretenduar edhe të ardhura nga shfrytëzimi i tokës bujqësore duke depozituar akt vlerësimit nr. *** prot., datë 8.10.2021, të Agjencisë Rajonale të Ekstencionit Bujqësor Shkodër, ku është përllogaritur prodhueshmëria *bruto* nga toka bujqësore e përfituar sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi.

b) Komisioni analizoi dokumentacionin e depozituar dhe nga përllogaritjet i rezultoi se të ardhurat e subjektit dhe familjarëve rezultojnë si në tabelën vijuese.

Përshkrimi	Periudha 2006 - 13.7.2010
Të ardhura nga paga subjekti 2006 – 2010	2,334,247
Të ardhura nga paga babai 2006 – 2008	1,002,845
Të ardhura nga paga nëna 2006 – 2007	265,976
Të ardhura nga paga bashkëshortja mars 2008 – 2010	1,012,850
Total të ardhura	4,615,918

²⁴Pyetësor nr. 3, datë 9.11.2021.

²⁵Që me kursin e këmbimit të tregut të lirë të kësaj date 1euro = 136.7 lekë janë 683.500 lekë.

c) Në vërtetimet e depozituara për të ardhurat e përfituara nga punësimi, në ato vite ku të ardhurat janë dhënë *bruto*, Komisioni ka kryer llogaritjet sipas legjislacionit të kohës për të përllogaritur të ardhurat *neto*.

ç) Gjithashtu, Komisioni përllogariti shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit dhe prindërit e tij për periudhën 2006 – korrik 2010, si dhe për bashkëshorten për periudhën mars 2008 – korrik 2010, të cilat i rezultuan në vlerën 2.116.116 lekë. Në analizën e kryer nuk janë përfshirë të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore.

d) Diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve rezultoi në shumën 2.499.802 lekë (4.615.918 lekë - 2.116.116 lekë).

dh) Për sa më sipër, për këtë burim krijimi të pasurisë, trupi gjykues, nga faktet dhe rrethanat e dala, si dhe nga përllogaritjet financiare të kryera, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë pasur mundësi të kursejnë shumën 1.700.000 lekë.

7.11.ii Në lidhje me burimin tjetër të krijimit të pasurisë – hua e dhënë nga prindërit e bashkëshortes në vlerën 1.200.000 lekë

a) Për këtë hua, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar²⁶: “Hua nga prindërit e bashkëshortes, G. Gj. dhe L.Gj. në shumën 1.240.000 lekë. 800.000 lekë janë tërhequr nga vjehrra ime L.Gj. në datën 8.7.2010, sipas formularit ‘nxjerrje llogarie’ ‘Tirana Bank’ për periudhën 1.1.2010 deri më 31.12.2010. Numri i llogarisë: ***. Nga vjehrra ime jam informuar se shuma e sipërcituar dhe shuma të tjera që figurojnë sipas nxjerrjes së llogarisë janë transferuar nga vëllai i saj P. P., i cili jeton dhe punon prej vitesh në Republikën e Greqisë. Shuma e mbetur prej 424.000 lekësh më është dhënë nga vjehërria, nga lekët që kanë pasur gjendje *cash*, në shtëpi. Theksoj se shuma prej 800.000 lekësh e tërhequr nga vjehrra ime L.Gj. në datën 8.7.2010 rrjedh nga llogaria bankare nr. ***, që është në emër të shtetasve P. P. dhe L. Gj., të cilët janë në lidhje gjinore ndërmjet tyre (vëlla e motër). Në lidhje me marrëdhënien me huadhënësin: raporti im me huadhënësit janë raporte krushqie, për shkak se bashkëshortja ime është fëmija i shtetasve G. dhe L.Gj.”.

b) Komisioni konstatoi se, në ndryshim nga deklarimi periodik ku subjekti ka deklaruar se huaja është marrë nga prindërit e bashkëshortes, gjatë hetimit ai ka sqaruar se vetëm vlera prej 424.000 lekësh është e prindërve të bashkëshortes dhe pjesa tjetër është marrë nga llogaria e përbashkët që vjehrra L.Gj. ka pasur me vëllain e saj, shtetasin P.P. .

c) Sa më sipër, Komisioni konstatoi mospërputhje në burimin e krijimit të huas nga prindërit e bashkëshortes, pasi këta të fundit i kanë dhënë subjektit vetëm vlerën 424.000 lekë nga lekët që kanë pasur gjendje *cash* në banesë, ndërsa shuma prej 800.000 lekësh është marrë nga llogaria bankare e përbashkët e shtetasit P. P. (vëllai i vjehrrës) dhe shtetas L. Gj. (vjehrra).

ç) Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti depozitoi në cilësinë e provës nxjerrjen e llogarisë për vitin 2010, me nr. llogarie: ***, në “Tirana Bank” në emër të shtetas L. Gj., si dhe deklaratë noteriale. Referuar deklaratës noteriale²⁷ të prindërve të bashkëshortes së subjektit (në cilësinë e huadhënësve), Komisionit i rezultoi se nga ana e tyre pranohej dhënia e huas në korrik të vitit 2010, në shumën totale prej 1.240.000 lekësh me qëllim blerjen e apartamentit nga shtetasi N. Gj. . Gjithashtu, ata pohuan se shuma është shlyer në mënyrë graduale, të pakushtëzuar nga ndonjë afat, përgjatë periudhës 2010 – 2014.

d) Nga verifikimi i llogarisë bankare, Komisionit i rezultoi se shtetasja L. Gj. ka tërhequr shumën 800.000 lekë, në datën 8.7.2010, sipas deklarimit të subjektit.

²⁶Pyetësor nr. 1, datë 9.1.2020.

²⁷Nr. ***, datë 5.10.2021, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 27.9.2021.

dh) Gjithashtu, në vijim të hetimit, subjekti depozitoi dokumentacion mbështetës²⁸ për shtetasin P. P., për të provuar të ardhurat e tij nga emigracioni në shtetin grek.

e) Komisionit, në analizim të dokumentacionit të depozituar për shtetasin P. P. dhe bashkëshorten e tij, i rezultoi si në tabelën vijuese.

Viti	Të ardhura P. P. (në euro) (1)	Të ardhura T.P. (në euro) (2)	Shpenzime jetese ²⁹ (në euro) (3)	Kursime (në euro) (1+2-3)
2004	6,000.00	6,000.00	10,612.00	1,388.00
2005	6,640.00	6,520.00	11,300.00	1,860.00
2006	7,750.00	6,200.00	11,820.00	2,130.00
2007	8,084.00	6,975.00	12,240.00	2,819.00
2008	8,055.86	6,975.00	12,960.00	2,070.86
2009	7,978.35	6,975.00	13,794.00	1,159.35
Total	44,508.21	39,645.00	72,726.00	11,427.21

ë) Nga përlllogaritjet, Komisionit i rezultoi se mundësia për kursim ishte në vlerën 11.427 euro.

f) Për sa më sipër, trupi gjykues ka konstatuar se shtetasi P.P. ka pasur mundësi të kursejë shumën 800.000 lekë, e cila i është dhënë hua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet shtetases L. Gj. .

g) Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit dhe deklaratave të subjektit në pyetësorët e dërguar, konstatoi se pavarësisht se subjekti ka deklaruar se llogaria bankare në “Tirana Bank” është në emër të shtetases L. Gj. (vjehera e subjektit) dhe vëllait të saj, P. P., nga dokumentacioni bankar nuk u konfirmua ky fakt. Kjo llogari rezultoi se ishte vetëm në emër të shtetases L. Gj. . Gjithashtu, rezultoi se subjekti nuk kishte depozituar prova për të vërtetuar faktin se shtetasi P. P. ishte pjesë e kësaj llogarie, pranimin e dhënies së shumës 800.000 lekë prej tij, apo faktin që kjo shumë ishte e tij.

- Pavarësisht që u konstatua se shtetasi P. P. kishte mundësi financiare për të krijuar shumën e dhënë hua subjektit, Komisioni, për të rezultuar në një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë argumentet në lidhje me këto konstatime: (i) mungesën e dokumentacionit justifikues për të provuar faktin se llogaria në “Tirana Bank” ishte në emër të shtetases L.Gj. dhe vëllait të saj, shtetasit P. P.; (ii) mungesën e dokumentacionit provues që shumat e depozituara dhe të tërhequra nga kjo llogari ishin të shtetasit P. P.; dhe (iii) mungesën e dokumentacionit provues për dakordësinë e shtetasit P. P. për dhënien e kësaj shume.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Subjekti, në prapësimet e tij lidhur me shumën e marrë hua nga prindërit e bashkëshortes, ka dhënë sërish shpjegimet: *“Risqaroj se në datën 8.7.2010 është tërhequr nga vjehera ime L.Gj. shuma prej 800.000 lekësh në llogarinë rrjedhëse me nr. ***. Qoftë në shpjegimet që kam dhënë në kuadër të pyetësorit standard, qoftë në përgjigje të pyetësorëve të tjerë, kam shpjeguar se më është dhënë hua shuma prej 1.240.000 lekësh, nga këto 800.000 lekë të vëllait të vjehrrës – shtetasit P. P. nga llogaria dyemërore. Në lidhje me këtë deklaram timin, i jam referuar deklaramit verbal që më ka dhënë vetë vjehera ime se këto janë lekët e vëllait të saj P. P., i cili jeton dhe punon në Greqi prej shumë vitesh. Ndërsa shuma e mbetur prej 424.000 lekësh më janë dhënë nga kursimet cash të vjehërrisë”.*

²⁸Me pyetësorin nr. 2, datë 27.9.2021.

²⁹<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do> (shpenzimet e jetesës për një person janë shumëzuar për dy).

Në lidhje me konstatimin e parë të Komisionit, për mungesë të dokumentacionit justifikues për të provuar faktin se llogaria në “Tirana Bank” ishte në emër të shtetases L. Gj. dhe vëllait të saj, shtetasit P.P., subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Vjehrra ime L. Gj. ka kërkuar informacion zyrtar nga ‘Tirana Bank’. Kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2021 ka vërtetuar faktin se: ‘[...] llogaria me nr. *** i përket znj. L. Gj. Gj., është llogari bashkëmërore me përfitues P. Gj. P., i datëlindjes 15.3.1966 dhe nr. personal ***”*.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit provues, që shumat e depozituara dhe të tërhequra nga kjo llogari janë të shtetasit P. P., subjekti ka sqaruar se: *“Sikurse u citua më sipër, llogaria rrjedhëse nr*** është llogari bashkëmërore e L.Gj. dhe P. P. . Në datën 13.9.2010 nga kjo llogari rrjedhëse, vjehrra ime L. Gj. ka kaluar në llogarinë rrjedhëse nr***, në emër të P.P. shumën prej 724.000 lekësh. Kjo llogari nga P. P. është çelur më vonë se ajo dyemërore. Pra, ai nuk ka pasur llogari rrjedhëse bankare vetëm të tijën më përpara. Më pas, shumën prej 724,000 lekësh vetë z. P. e ka kaluar në llogarinë e depozitës së tij, çka tregon se edhe shuma prej 800.000 lekësh që më është dhënë mua nëpërmjet vjehrrës sime (dhe është tërhequr nga kjo llogari), kanë qenë të hollat e kursimeve të z. P. ”*.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit provues për dakordësinë e shtetasit P. P., për dhënien e kësaj shume, subjekti ka sqaruar se: *“Në datën 20.12.2021 shtetasi P. P. ka shprehur vullnetin e tij të lirë në një deklaratë solemne me shkrim, përpara autoritetit kompetent shtetëror të Republikës së Greqisë”*.

Në mbështetje të pretendimeve dhe argumenteve të tij, subjekti ka depozituar dokumentacion provues³⁰.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, për të provuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratimit të tij dhe, për pasojë, edhe ligjërimin e këtij burimi krijimi të pasurisë objekt i këtij hetimi administrativ, arsyeton si vijon:

Lidhur me konstatimin e mungesës së dokumentacionit justifikues, për të provuar faktin se llogaria në “Tirana Bank” ishte në emër të shtetases L.Gj. dhe vëllait të saj, P. P., subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 22.12.2021, nga “Tirana Bank”, nga analiza e të cilit, trupi gjykues vëren se llogaria me nr. *** , që i përket shtetases L. Gj., nga e cila është tërhequr edhe shuma prej 800.000 lekësh, është llogari bashkëmërore me përfitues shtetasin P. Gj. P., vëllain e saj.

Lidhur me konstatimin e mungesës së dokumentacionit justifikues, për të provuar që shumat e depozituara dhe të tërhequra nga kjo llogari janë të shtetasit P.P., trupit gjykues, nga verifikimi i statementit bankar, i rezultoi se nga shumat e depozituara në këtë llogari është kryer një transfertë nga kjo llogari në atë të shtetasit P.P. . Ky i fundit, vërehet se shumën e transferuar e ka investuar në depozitë. Sa më sipër, trupi gjykues krijon bindjen se këto transaksione që i përkasin shumave të depozituara dhe të tërhequra nga/për në këtë llogari janë të shtetasit P. P..

Në lidhje me konstatimin e mungesës së dokumentacionit justifikues, për të provuar dakordësinë e shtetasit P.P., për dhënien e kësaj shume, në favor të motrës së tij si një hua për subjektin e rivlerësimit, subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale³¹ të shtetasit P., nga

³⁰Shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2021, nga “Tirana Bank” drejtuar shtetases L.Gj. dhe deklaratën e datës 20.12.2021, të përpiluar nga shtetasi P. P. në zyrën e Shërbimit të Qytetarëve të Bashkisë së S., të vërtetuar me vulë apostile nga Prefektura L., të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe sipas vërtetimit njësisia me origjinalin të noteres M. D. nr. *** rep., datë 23.12.2021.

³¹Në formën e kërkuar nga ligji, me vulë apostile për shtetasit që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

verifikimi i së cilës, trupi gjykues konstatoi se konfirmohej fakti i huadhënies dhe shprehja e dakordësisë së tij, për dhënien e shumës 800.000 lekë në favor të subjektit.

Në përfundim, trupi gjykues konkludon se shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti krijojnë bindjen se: (i) llogaria bankare është bashkëmërore; (ii) shumat e depozituara janë të shtetasit P. P. (kjo edhe për faktin se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, shtetasi P.P. rezultoi se ka pasur³² mundësi financiare të krijojë kursime), si dhe iii) u provua në mënyrë të qartë dhe të vullnetshme shprehja e dakordësisë së tij për këtë huadhënie.

Lidhur me të ardhurat e prindërve të bashkëshortes subjekti ka sqaruar³³ se: *“Ata kanë pasur të ardhura mëse të mjaftueshme pasi kanë shitur një pronë në vitin 2001, me vlerë 375.000 lekë dhe në vitet 2005 – 2010 vjehrra ‘L. Gj.’, si person fizik me NIPT *** ‘tregtim me pakicë materiale ndërtimi, vegla pune, pajisje hidraulike, etj.’, ka ushtruar një aktivitet tregtar në të cilin ka pasur të ardhura të konsiderueshme. Po ashtu, duke qenë se familja e vjehërrve ka tokë bujqësore, shpenzimet e tyre të jetesës kanë qenë ndjeshëm më të ulëta krahasuar me një familje tjetër pa tokë bujqësore. Mundësia e kursimit të familjes së vjehërrve të mi vërehet indirekt edhe nga depozita bankare që vjehrra L.Gj. ka pasur në BKT Lezhë, në llogarinë me nr. ***, ku nga viti 2006 deri në vitin 2008 shuma e kursimeve dhe depozitave ka ardhur duke u rritur (ku në fund më 5.5.2008 është tërhequr prej saj shuma 1.779.669 lekë)”*.

Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka depozituar shkresën nr. ***prot., datë 21.1.2020, nga DRT-ja Lezhë dhe shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2021, nga Bashkia Lezhë, për të vërtetuar ushtrimin e aktivitetit, si dhe qarkullimin e realizuar nga ky aktivitet.

Komisioni, duke iu referuar natyrës së aktivitetit tregtar që kanë ushtruar prindërit e bashkëshortes (tregtim materiale ndërtimi), vlerësoi që fitimi i mundshëm ka qenë në masën 30% të qarkullimit.

Viti	Qarkullimi i deklaruar/parashikuar	Fitimi i mundshëm 30%
2004	1,400,000	420,000
2005	1,500,000	450,000
2006	1,750,000	525,000
2007	1,750,000	525,000
2008	2,000,000-3,000,000	600,000
2009	2,000,000	600,000
Total	10,400,000	3,120,000
½	5,200,000	1,560,000

Komisioni, gjithashtu vlerësoi se, edhe sikur qarkullimi i realizuar të ketë qenë sa ½ e qarkullimit të deklaruar/parashikuar, përsëri fitimi i realizuar do të ishte në një shumë që e mbulon vlerën prej 424.000 lekësh, të dhënë hua ndaj subjektit.

Për sa më sipër, trupi gjykues ka konkluduar se prindërit e bashkëshortes kanë pasur mundësi të kursejnë shumën 424.000 lekë dhe t’ia japin hua subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie.

Edhe pse konstatimi i Komisionit, sa i përket mundësisë së kursimit nga prindërit e bashkëshortes së subjektit të shumës së dhënë hua, ka rezultuar pozitiv, subjekti ka paraqitur pretendime në prapësimet e tij, duke pretenduar: *“Në lidhje me mundësinë e dhënies hua në shumën 424.000 lekë nga prindërit e bashkëshortes time, megjithëse Komisioni është shprehur*

³²Referojuni pikës 7.11.ii germa e) në këtë vendim.

³³Pyetësori nr. 3, datë 9.11.2021.

se ata kanë pasur mundësi për të më dhënë një shumë të tillë, më duhet të kundërshtoj këtë përlllogaritje sepse ajo afekton burime të tjera pasurish”. Subjekti ka pretenduar një marzh fitimi më të lartë nga ai i përlllogaritur nga Komisioni, si dhe qarkullimin e vitit 2008, të përlllogaritur minimalisht në vlerën 2.500.000 lekë dhe jo 2.000.000 lekë, siç e ka marrë Komisioni.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në analizë tërësore për këtë pasuri, konstatoi se pretendimet e subjektit për të përlllogaritur një marzh fitimi më të lartë se sa u vlerësua nga Komisioni, nuk qëndrojnë për arsyt e pasqyruara në vijim, por gjithashtu vëren se edhe nëse do të rezultonte një fakt i tillë, ai nuk do të ndikonte në asnjë nga pasuritë e tij.

Trupi gjykues vlerësoi se në bazë të fushës së veprimtarisë, aktiviteti i prindërve të bashkëshortes kishte një marzh fitimi prej 30% dhe jo 60% apo më shumë se 100%, sa është pretenduar nga subjekti.

Nga ana tjetër, trupi gjykues ka përlllogaritur, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, qarkullimin e vitit 2008, në vlerën 2.000.000 lekë, pasi në dokumentacionin e depozituar nga subjekti, vërtetë shihet se parashikimi ka qenë në masën 2-3 milionë lekë, por taksat janë paguar për vlerën 2.000.000 lekë. Sipas legjislacionit të kohës së ushtrimit të aktivitetit (referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”), për qarkullimin 0-2 milionë/vit paguhej vetëm kuota fikse, ndërsa për qarkullim 2-8 milionë paguhej kuota fikse në organet vendore, si dhe tatim i thjeshtuar mbi fitimin në masën 10% mbi qarkullimin total. Në këto kushte, ka rezultuar se për vitin 2008 është paguar vetëm kuota fikse dhe taksat vendore dhe, për këtë arsye, qarkullimi është marrë në vlerën 2.000.000 lekë.

Sa më sipër, trupi gjykues konkludoi se pretendimet e subjektit për një marzh fitimi më të lartë (se 30%) në të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i ushtruar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, nuk qëndrojnë, pasi nuk mbështeten në fakt dhe prova.

7.11.iii Në lidhje me huan në shumën 5.000 euro

a) Në lidhje me këtë hua, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar³⁴: “Hua nga shtetasi A.M. (baxhanaku) në shumën 5.000 euro, nëpërmjet vjehrrit G. Gj. . Tërhequr shuma në datën 9.7.2010 sipas nxjerrjes së llogarisë nr. ***, në ‘Tirana Bank’. Në lidhje me marrëdhënien me huadhënësin subjekti ka deklaruar: “Me huadhënësin jemi baxhanakë, pra bashkëshortet tona D.M. dhe L.M. janë motra ndërmjet tyre”. Në lidhje me kushtet e shlyerjes, subjekti deklaroi: “Shuma është shlyer nga momenti i marrjes së muajit korrik 2010 deri para deklarimit para fillimit të detyrës në muajin tetor 2014”.

- Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar nxjerrjen e llogarisë për vitin 2010 me nr. llogarie ***, të “Tirana Bank”, në emër të shtetasit G. Gj., si dhe një deklaratë noteriale³⁵. Edhe shtetasi A. M., nëpërmjet deklaratës noteriale³⁶ të depozituar nr. ***, datë 5.10.2021, ka pranuar dhënien e huas në vitin 2010 nga shumat e disponuara në llogarinë bankare të përbashkët me vjehrrin G.Gj. . Me aprovimin e tij, ky i fundit ka tërhequr shumën 5.000 euro (nga llogaria nr. *** në “Tirana Bank”) dhe i është dhënë hua subjektit pa interes dhe pa afat. Gjithashtu, ai ka pohuar se shuma është shlyer plotësisht nga subjekti, në mënyrë periodike dhe jashtë sistemit bankar.

³⁴Në pyetësorin nr. 1, datë 9.1.2020.

³⁵Nr. ***, datë 5.10.2021, e shtetasit G.Gj., depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 27.9.2021.

³⁶Nr. ***, datë 5.10.2021, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 5.10.2021.

b) Nga verifikimi i llogarisë bankare, Komisionit i rezultoi se shtetasi G.Gj. e ka tërhequr shumën 5.000 euro në datën 9.7.2010, sipas deklaramit të subjektit.

c) Gjithashtu, në vijim të hetimit, subjekti depozitoi dokumentacion mbështetës³⁷ për shtetasin A. M., për të provuar të ardhurat e tij nga emigracioni.

ç) Komisionit, në analizim të dokumentacionit të depozituar për shtetasin A. M., i rezultoi si në tabelën vijuese.

Viti	Të ardhura A.M. (në euro) (1)	Shpenzime jetese ³⁸ (në euro) (2)	Kursime (në euro) (1-2)
2007	9,583.02	6,120.00	3,463.02
2008	9,586.00	6,480.00	3,106.00
2009	10,501.00	6,897.00	3,604.00
Total	29,670.62	19,497.00	10,173.02

Nga përlllogaritjet rezultoi se mundësia për kursim ishte në vlerën 10.173 euro.

d) Nën këtë analizë financiare të prodhuar mbi bazë dokumentacioni nga Njësia e Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konkludoi se shtetasi A. M. ka pasur mundësi të kursejë shumën 5.000 euro dhe t'ia japë hua subjektit të rivlerësimit.

dh) Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në konkluzion se provohet ligjshmëria e secilit prej burimeve të krijimit të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, sipas kërkesave të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

7.12 Lidhur me shlyerjet e huave të marra për këtë pasuri

7.12.i Meqenëse këto hua rezultuan të marra përpara emërimit në detyrë, Komisioni e pyeti³⁹ subjektin për kohën e shlyerjes së tyre.

7.12.ii Subjekti, për të gjitha huat, ka deklaruar se janë shlyer gradualisht pas marrjes në muajin korrik të vitit 2010, deri para deklaramit të fillimit të detyrës në muajin tetor të vitit 2014.

7.13 Komisioni kreu analizën financiare duke përfshirë të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e identifikuar për këtë periudhë. Në këtë analizë nuk u përfshinë të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit në emigracion, pasi nuk u provuan prej tij me dokumentacion justifikues, si dhe të ardhurat e mundshme të përfituara nga toka bujqësore e përfituar me ligjin nr. 7501/1991, pasi subjekti nuk kishte përcaktuar vlerën e tij takuese. Pas kryerjes së analizës financiare subjektit i kaloi barra e provës⁴⁰, pasi dukej se nuk kishte pasur mundësi financiare, që në periudhën korrik 2010 – tetor 2014 të kryente të gjitha investimet në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe të shlyente huat e marra.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

³⁷Me pyetësorin nr. 2, datë 27.9.2021.

³⁸<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do> (shpenzimet e jetesës për një person janë shumëzuar për dy).

³⁹Me pyetësorin nr. 2, datë 27.9.2021.

⁴⁰Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7.14 Subjekti, në parashtrimet e tij⁴¹ lidhur me konstatimet e Komisionit sa i përket analizës financiare, paraqiti disa pretendime duke ripërsëritur këtu edhe të ardhurat e përfituara nga emigracioni. Në mënyrë të detajuar subjekti ka pretenduar si vijon:

Në lidhje me blerjen e tri sipërfaqeve të tokës bujqësore⁴², subjekti, së pari, ka pretenduar se: *“Komisioni ka aplikuar një qëndrim kontradiktor me veten e tij, pasi megjithëse në raport (në faqen 4, pika 3.4) ka pranuar si të rregullt kontratat e shitjes vetëm nga prindërit tanë të sipërfaqeve të tokës të përfituara nga të gjashtë pjesëtarët e familjes tonë me ligjin nr. 7501, ndërkohë që nga ana tjetër kanë përfshirë si pjesë të çmimit të blerjes edhe blerjen nga unë të 1/6 të pjesës time takuese”*. Sa i përket analizës financiare të Komisionit për këtë pasuri, subjekti ka pretenduar se *Komisioni më ka nxjerrë me një pamjaftueshmëri të lartë financiare, e cila vjen tërësisht në kundërshtim me gjendjen time të burimeve të ardhurave dhe mundësi të kursimit*, ndërsa sa i përket përlllogaritjes së vlerës së paguar prej tij ka pretenduar se: *“Kam qenë bashkëpronar me 1/6 pjesë takuese të sipërfaqes prej 13,954 m² të blerë me datë 19.5.2012, nga ana tjetër Komisioni ka përlllogaritur se unë e kam blerë atë në vlerën e plotë prej 3.571.824 lekë sa ç’paraqitet në çmimin e blerjes, pa i zbritur asaj vlerën korresponduese prej 594.971 lekësh në të cilën unë kam qenë pronar dhe nuk kisha se si të blija një send të cilin e kisha në pronësi. Për rrjedhojë, në të gjitha variantet, duke qenë se unë kam qenë bashkëpronar në 1/6 pjesë takuese të këtyre pasurive të blera, Komisioni duhet të përlllogarisë si çmim blerjeje efektiv të shpenzuar nga unë vetëm vlerën korresponduese të 5/6 të tyre prej 2.976.853 lekë”*.

Gjithashtu, subjekti ka dhënë sqarime edhe mbi mënyrën e pagesave, vlerën dhe burimin e tyre, sa i përket blerjes së tri pasurive të llojit “arë” nga prindërit e tij, duke deklaruar specifikisht se: *“Në lidhje me pagimin e vlerës korresponduese të çmimit të 5/6 të pjesëve të blera prej 2.976.853 lekësh, në momentin e nënshkrimit të kontratës së datës 19.5.2012, ashtu siç janë shprehur edhe prindërit e mi në deklaratën noteriale të datës 28.12.2021, unë u kam dhënë atyre cash vetëm shumën prej 1.500.000 lekësh, shumë e kursyer nga pagat e dy bashkëshortëve përgjatë periudhës korrik 2010 – maj 2012 të analizuara më lart (në një shumë rreth 700.000 lekë) dhe përfitimi i dëmshpërblimit të rrjedhur nga largimi në mënyrë të njëanshme nga puna (në shumën 800.000 lekë)”. Në vijim, subjekti ka sqaruar se: “Për pjesën e mbetur prej 1.476.853 lekësh jemi marrë vesh me prindërit që kjo shumë të kompensohet me pjesën takuese të fitimeve të pa marra nga prodhimet bujqësore që nga viti 1995 e deri në këtë datë (të paraqitura më lart), të ardhurat e siguruara nga emigracioni dhe që u janë dërguar prindërve, si dhe pjesën takuese të çmimit të shitjes së tokës bujqësore z. S. M. në vitin 2006 (në vlerën 2.000.000 lekë), e cila pas shtimit të interesave bankare të përfituara kishte arritur në vlerën 2.698.241 lekë, ku pjesa ime takuese prej 1/6 ishte në shumën 449.706 lekë”*.

Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të prindërve të tij, të datës 28.12.2021, për të cilën pohon se: *“Prindërit e mi me deklaratën noteriale të datës 28.12.2021 kanë deklaruar detajet e mësipërme dhe marrëdhëniet tona njerëzore familjare dhe ato mbi pagimin e çmimit të blerjes dhe kompensimin e tyre me detyrime të ndërsjella tonat”*.

Sa i përket analizës financiare në tërësi, të kryer nga Komisioni, subjekti ka ngritur pretendimin se *“Komisioni ka përjashtuar nga përdorimi si burim krijimi të pasurive të mia të ardhurat e mia dhe të familjes sime para datës 13.7.2010”*, duke evidentuar disa burime të ardhurash, si vijon:

⁴¹Datë 29.12.2021.

⁴²Kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.5.2012, me palë shitëse shtetasit L. dhe D.M. (prindërit e subjektit) dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit.

“Gentian Marku nga data 9.1.2006 deri më 13 korrik, të ardhurat neto rezultojnë në shumën 2.832.143 lekë. Ndërkohë për vitet 2006 - 2007 (kur unë kam jetuar me prindërit) të ardhurat e mia nga paga kanë qenë në shumën 1.240.673 lekë.

*Të ardhurat nga paga, të babait L. M. referuar lëvizjes së llogarisë nr***, në emër të tij për periudhën 1.1.2005 – 30.11.2010, ku nga mbledhja e viteve 2006 - 2007 rezultojnë të ardhurat në vlerën 728.352 lekë.*

Ndërkohë, nëna ime D. M. në vitin 2006 deri në mars 2007 ka realizuar të ardhura nga paga në shumën 248.831 lekë dhe deri në fund të vitit 2007 nga pensioni shumën 135.212 lekë, që në total në këto vite është shuma e të ardhurave prej 384.043 lekësh.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur të ardhura nga tjetërsimi i një sipërfaqeje toke, konkretisht, nga shitja e tokës bujqësore në datën 7.2.2006 kundrejt çmimit 2.000.000 lekë. Siç kam deklaruar edhe më parë, kjo shumë është depozituar në banka (njëra pas tjetrës për të kërkuar interesa sa më të larta nga ‘Pr Credit Bank’ në NBG Bank) nga babai dhe ndër vite ka ardhur duke u shtuar, duke sjellë në total një përfitim interesash nga kjo shumë (nga aktekspertimi janë paraqitur përfitimet vjetore të interesave bankare) në vitin 2012 në vlerën 698.241 lekë që bashkë me principalin arrijnë në 2.698.241 lekë. Duke qenë se unë kam qenë pronar i 1/6 pjesë takuese të kësaj toke, unë kam përfituar shumën prej 449.706 lekësh, e cila është kompensuar me çmimin e blerjes së tokës bujqësore prej 13.954 m² nga ana ime në maj 2012.

*Po ashtu, duke qenë se ne kemi pasur një sipërfaqe të konsiderueshme toke bujqësore në fushën e *** në fshatin P., të cilën e kemi kultivuar në mënyrë intensive që nga përfitimi i saj, ne kemi siguruar të ardhura të konsiderueshme qoftë financiare nga shitja e produkteve të prodhuara në të, qoftë nga ulja e shpenzimeve jetike si rezultat i prodhimeve të saja për nevoja familjare. Duke qenë se në raport, Komisioni në pikën 7.11 është shprehur se ‘nuk janë përfshirë në analizën financiare ... të ardhurat e mundshme të përfituara nga toka pasi subjekti nuk ka përcaktuar vlerën e tij takuese’, unë kam kërkuar nga një agronom kryerjen e një vlerësimi ekonomiko-agrar për mundësitë e fitimit neto të kësaj sipërfaqeje toke ndër vite. Sipas këtij aktekspertimi, gjatë kësaj periudhe ne kemi pasur të ardhura nga toka bujqësore, ku në vitet 1995 – 2004 kemi pasur të ardhura neto në shumën 5.117.200 lekë, ndërsa në vitin 2005 shumën 249.678 lekë fitim neto, në vitin 2006 – 591.370 lekë, në vitin 2007 – 591.370 lekë. Pra, vetëm në vitet 2005 – 2007 kemi pasur 1.432.418 lekë. Sa i përket pjesës time takuese, nga ky përfitim sqarohet se unë kam përfituar 1/3 e saj, pasi vëllai dhe dy motrat nuk kanë punuar dhe as kontribuar në kultivimin e saj. Pra, ata kanë përfituar çmimin për pjesën e tyre në bashkëpronësi kur pjesa e tyre është shitur, por nuk kanë përfituar nga puna dhe aktiviteti bujqësor në këto vite të përmendura më lart, të cilat janë kryer nga unë dhe dy prindërit. Në rastet kur ata (vëllai dhe motrat) kanë ardhur për vizita (që kanë qenë të rralla) ne u kemi dhënë prodhime të stinës që kemi pasur gjendje, por as është kërkuar prej tyre dhe as nuk u kemi dhënë ndonjëherë pjesë nga fitimet e realizuara nga shitja e prodhimeve bujqësore (pasi ajo është në pjesën më të madhe të saj rezultat i punës). Sipas këtij raporti pjesa ime takuese e fitimit nga shitja e prodhimeve bujqësore për vitet 2005 – 2007 ka qenë 477.472 lekë. Ndërkohë raporti i fitimit për pjesën time takuese për vitet pararendëse 1995 – 2004 në shumën totale 5.117.200 lekë ka qenë më i vogël se 1/3, pasi një pjesë të periudhës në fjalë kam qenë minorene dhe në familje kanë qenë disa vite edhe vëllai dhe dy motrat (për rrjedhojë pjesa ime takuese në këtë periudhë varion mes 1/3 dhe 1/6).*

Nga ana tjetër, siç kam deklaruar në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, bashkëshortja ime D. ka sjellë në pajë shumën prej 500.000 lekësh si dhuratë nga prindërit e saj. Në fakt, kjo shumë ka qenë nga paga e saj si mësuese gjatë vajzërisë, të cilën prindërit e saj nuk e kanë prekur për shpenzime jetese, duke ia lënë që ta merrte me vete si nuse kur të martohej (siç bëjnë shumica e familjeve të zonës së Z. ende edhe sot).

Për sa i përket periudhës 10.1.2008 – 13.7.2010, nga eksperti janë përlllogaritur të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes dhe të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore. Bashkëshortja D. ka përfituar në vitin 2008 (nga 20 mars pas martese - 31 dhjetor) shumën prej 293.482 lekësh, në vitin 2009 shumën 424.084 lekë dhe në vitin 2010 deri në datën 13.7.2010 shumën prej 208.247 lekësh, që në total janë 925.813 lekë.

Unë kam përfituar nga paga ime në vitin 2008 shumën prej 716.395 lekësh, në vitin 2009 shumën 391.276 lekë dhe në vitin 2010 deri në datën 13.7.2010 shumën prej 298.212 lekësh që në total janë 1.405.883 lekë. Pra për këtë periudhë të dy bashkëshortët kemi përfituar nga paga shumën prej 2.331.696 lekësh.

Në këtë periudhë kam pasur të ardhura nga prodhimet bujqësore, ku sipas aktekspertimit për vitin 2008 janë në shumën prej 591.370 lekësh, në vitin 2009 në shumën 591.370 lekë dhe në vitin 2010 (duke përlllogaritur ½) deri në datën 13.7.2010 shumën prej 229.380 lekësh, që në total janë 1.412.120 lekë. Pjesa ime takuese në 1/3 e këtyre të ardhurave është 470.706 lekë”.

Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka depozituar aktekspertimin kontabël, dhjetor 2021 dhe analizën financiare të të ardhurave për vitet 1995 – 2011 dhe 2011 – 2014 për shtetasit L.M. dhe Gentian Marku, përgatitur nga një ekspert agronom, datë 26.12.2021.

Sa i përket të ardhurave nga emigracioni, subjekti ka pretenduar se: *“Përveç këtyre të ardhurave, siç jam shprehur edhe më lart unë kam siguruar të ardhura dhe kursime të konsiderueshme nga puna në emigrim në Itali, ku për shkaqe objektive nuk e kam pasur të mundur që të siguroj dokumente, pasi për pjesën më të madhe të kohës nuk kam pasur dokumente të rregullta qëndrimi”.*

Sa i përket shpenzimeve jetike, subjekti ka pretenduar se: *“Sa i takon shpenzimeve jetike gjatë këtyre viteve ne kemi qenë 3 pjesëtarë në familjen tonë (unë dhe dy prindërit) dhe për shkak të pasjes dhe marrjes së shumë prodhimeve bujqësore dhe blegtorale nga toka jonë dhe bagëtitë që kemi mbarështuar, ato kanë qenë në nivele shumë të ulëta (kryesisht për zëra të produkteve industriale dhe shpenzime të tjera)”.*

Sa i përket kursimeve, subjekti ka pretenduar se: *“Duke marrë në total të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj periudhe deri në datën 13.7.2010 unë kam pasur mundësi kursimi jo vetëm për shumën 1.700.000 lekë, të përdorura për blerjen e apartamentit me sip. 69.05 m², por edhe kursime të tjera shtesë. Një pjesë e këtyre kursimeve prej 1.000.000 lekësh i janë dhënë hua pa interes nga ana ime motrës sime A. M. në janar 2010 për shkak të nevojave të saj familjare. Ky borxh (hua) është shlyer nga motra gjatë vitit 2013, siç është pohuar edhe prej vetë saj në deklaratën noteriale të paraqitur bashkëngjitur këtyre prapësimeve”. Në vijim, subjekti lidhur me këtë hua ka deklaruar se: “Sqaroj Komisionin se duke mos qenë në atë kohë subjekt i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ‘Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive’, unë nuk kam pasur detyrim dhe as mundësi praktike që ta deklaroj dhënien dhe shlyerjen e një huaje të tillë. Shlyerja e kësaj huaje nga motra në vitin 2013, përpara se unë të bëhesha gjyqtar, ka përjashtuar edhe mundësinë e deklarimit të saj nga unë në deklarimin e parë para fillimit të detyrës në vitin 2014. Po ashtu, duke qenë se nuk jam pyetur nga Komisioni ndonjëherë për një fakt të tillë të ndodhur në vitin 2010, unë nuk e kam përmendur në mënyrë të pakërkuar dhe as të trajtuar indirekt në ndonjë çështje që është bërë objekt hetimi”.*

- Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.12.2021, të motrës së tij A. M., e cila ka deklaruar se në janar të vitit 2010 i ka marrë hua vëllait të saj (subjektit të rivlerësimit) shumën 1.000.000 lekë, pa interes dhe ia ka kthyer gjatë vitit 2013. Gjithashtu, ka pohuar se në kohën e dhënies së shumës nuk kanë përpiluar kontratë huaje për shkak të marrëdhënies gjinore të tyre.

- Në përfundim të argumenteve të tij, subjekti ka pohuar se: “Gjithsesi, unë kam sqaruar qartësisht gjithnjë se për krijimin e pasurive të mia në vitet 2010 – 2014 janë përdorur edhe të ardhurat dhe kursimet e realizuara nga unë para vitit 2010, duke filluar së paku që nga koha kur unë jam bërë madhor dhe i aftë për punë”.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

7.15 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë dhe parashtrimeve të tij në prapësime, arsyeton si vijon:

Lidhur me pretendimet e subjektit për blerjen e tri sipërfaqeve të tokës bujqësore nga prindërit e tij⁴³, se ai nuk ka paguar vlerën e përshkruar në kontratë për disa arsye të qenësishme dhe, më konkretisht, se i janë zbritur nga çmimi i parashikuar në kontratë: (i) vlera që i takon pjesës së tij takuese prej 1/6; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive (ku gjithashtu ai zotëron 1/6) nga babai i tij si kryefamiljar; si dhe (iii) kontributi i tij i dhënë në familje deri para martesë, si familje bujqësore në punimin e tokës dhe shitjen e produkteve bujqësore, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e administruar, si dhe shpjegimet e subjektit ku për këtë çështje objekt vlerësimi arsyeton:

Trupi gjykues, nisur nga faktet e dala nga hetimi se (i) sipërfaqet e tokave janë përfituar nga të gjashtë pjesëtarët e familjes me ligjin nr. 7501/1991 dhe se (ii) marrëdhëniet kontraktore të krijuara mes palëve janë marrëdhënie të posaçme brenda anëtarëve të familjes bujqësore dhe, për sa kohë provohet se ata kanë ndërvepruar bashkërisht duke shitur pjesë po nga kjo sipërfaqe toke, apo produkte bujqësore të prodhuara nga kjo pasuri, çmon se ndërveprimet mes tyre janë zgjedhje e anëtarëve të familjes bujqësore, që janë karakterizuar nga një pjesëtim pasurie i pranuar në heshtje, pra me pëlqimin e secilit anëtar sikurse e kërkon neni 226 i Kodit Civil. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë dhe faktin së përgjatë hetimit nuk u evidentua ndonjë rrethanë që të dëshmonte pretendime nga anëtarët e familjes, sikurse parashikohet në nenin 227⁴⁴ të Kodit Civil. Në këtë linjë arsyetimi, trupi gjykues gjen të pranueshëm pretendimin e subjektit se ai nuk ka paguar në blerjen e këtyre pasurive edhe shumën e përfituar nga shitja e pasurisë⁴⁵ prej 449.706 lekësh, e cila është kompensuar me çmimin e blerjes së tokës bujqësore me sip. 13.954 m², në maj të vitit 2012, për vetë faktin se subjekti ka qenë gjithashtu edhe në këtë shitje të pasurisë në pjesë takuese 1/6. Trupi gjykues, në këtë logjikë arsyetimi, ka përforcuar bindjen e tij nisur edhe nga fakti se gjatë hetimit konstatoi që shuma totale e përfituar nga shitja e pasurisë në vitin 2006 së bashku me interesat ka vijuar të qëndrojë në bankë edhe pas blerjes së pasurive nga subjekti.

Trupi gjykues, përveç sa arsyetoi më sipër, çmon gjithashtu se pavarësisht se deklarata noteriale⁴⁶ e prindërve të subjektit është dhënë gjatë procesit, ku deklarohet se nga çmimi total i përcaktuar në kontratën e shitjes për tokat arë, subjekti ka paguar vetëm vlerën 1.500.000 lekë, vlerësohet si një deklaram/pëlqim i dhënë si anëtarë të familjes bujqësore për zgjedhjen që kanë bërë.

- Sa më sipëranalizuar, trupi gjykues arriti në konkluzion se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm qëllimin dhe vërtetësinë e lidhjes kontraktore, si dhe vlerën reale të paguar për këto tri pasuri.

⁴³Kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.5.2012, me palë shitëse shtetasit L. dhe D.M. (prindërit e subjektit) dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit.

⁴⁴Çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore. Ajo përcaktohet duke marrë parasysh sidomos: (a) pasurinë që i përket tërë familjes; (b) numrin e anëtarëve të familjes; (c) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

⁴⁵Me kontratën nr. ***, datë 7.2.2006.

⁴⁶Nr. ***, datë 28.12.2021.

Lidhur me pretendimin e subjektit për mospërfshirjen në analizën financiare të të gjitha të ardhurave të tij familjare para datës 13.7.2010, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 13.7 – 31.10.2014, periudhë që korrespondon pas blerjes së apartamentit dhe para fillimit të detyrës së subjektit. Të ardhurat përpara kësaj periudhe që pretendon subjekti (periudha 2006 – 13.7.2010) janë përfshirë nga Komisioni në analizën e kryer për blerjen e apartamentit në vitin 2010. Në këtë analizë janë përfshirë të gjitha të ardhurat nga punësimi i prindërve, subjektit dhe bashkëshortes së tij pas martesë, sipas deklaramentit të tij dhe dokumentacionit të depozituar dhe atij të administruar nga Komisioni.

Për periudhën 2006 – 13.7.2010, trupit gjykues nuk i rezultuan problematika dhe kursimet janë marrë në konsideratë sipas deklaramentit të subjektit në vlerën 1.700.000 lekë.

- Sa më sipër, analiza financiare është kryer duke u bazuar në të dhënat, faktet dhe deklaramentet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, pasi subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe nuk ka pasur detyrimin për deklarim në ILDKPKI. Për rrjedhojë, për sa kohë që subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të qartë burimet e pasurive, trupit gjykues ka marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e përfituara nga punësimi, pas ndarjes së tij nga familja e origjinës, pra të ardhurat e përfituara nga subjekti dhe bashkëshortja, për periudhën korrik 2010 – tetor 2014, sipas deklaramentit të tij.

Lidhur me pretendimet e subjektit për të ardhurat nga emigracioni, trupit gjykues është shprehur edhe më sipër, duke konkluduar se subjekti ka depozituar dokumentacion që provon vetëm një pjesë të vogël të shumës së pretenduar. Trupit gjykues vlerëson se edhe një kursim i mundshëm nga emigracioni, minimalisht, do të ishte përdorur në vitin 2010, kur u investua në blerjen e apartamentit të trajtuar më sipër, si periudhë më e afërt nga viti i përfitimit të tyre (1999 – 2002). Mbi këto të ardhura, trupit gjykues çmon se pavarësisht se nga subjekti ato pretendohen se janë krijuar gjatë tranzicionit, mosmarrja e tyre në konsideratë nuk ka peshë të tillë që mund të passjellë një impakt thelbësor në analizën financiare për krijimin e pasurive tokë *arë* dhe investimeve të tjera përgjatë periudhës 2010 – 2014.

Lidhur me shpenzimet e jetesës dhe me pretendimin e subjektit për t'i reduktuar ato, qëndrimi i trupit gjykues ka qenë i njëjtë në çdo vendimmarrje të tij referuar standardit të krijuar, duke iu referuar INSTAT-it lidhur me shpenzimet jetike. Në këtë kuadër, vlerësohet se shpenzimet nuk mund të reduktohen dhe nuk merret në konsideratë pretendimi i subjektit që për faktin se fëmijët kanë qenë minorenë, ato duhet të jenë më të ulëta.

- Trupit gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, ripërlllogarit shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit, ku në periudhën 13.7.2010 – 4.6.2011 familja ka qenë me 3 anëtarë dhe, më tej, me 4 anëtarë.

Lidhur me huan që subjekti pretendon se i ka dhënë motrës së tij, në vlerën 1.000.000 lekë, trupit gjykues, ndodhur përpara faktit të një marrëdhënieje familjare, të krijuar përpara emërimit të subjektit në detyrë, çmon se marrja ose jo në konsideratë e kësaj shume nuk ndikon në këtë vendimmarrje.

Në konkluzion, pas ripërlllogaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, duke marrë në konsideratë një pjesë të pretendimeve të subjektit, si dhe duke mos përfshirë huan në vlerën 1.000.000 lekë të kthyer nga motra e subjektit, analiza financiare rezulton në balancë negative në vlerën 1.329.497 lekë. Trupit gjykues çmon se kjo balancë, për pasuritë e subjektit të krijuara përpara emërimit të tij në detyrë, në vlerësimin tërësor në këtë vendimmarrje, nuk mund të përbëjë rrethanë për penalizimin e tij.

7.16 Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit për këtë pasuri, Komisioni ka mbajtur korrespondencë edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat në

përgjigjet⁴⁷ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve, ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shtetasit J. M. dhe/ose A. P. .

- Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

8. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, çelur në vitin 2006. Gjendja në llogari në datën 10.1.2017, në vlerën 40.168,63 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentin “nxjerrje llogari bankare datë 10.1.2017, nga ‘Raiffeisen Bank’, në emër të Gentian Marku, në vlerën 40.168 lekë”⁴⁸.

8.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ‘Raiffeisen Bank’”*.

8.2 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2020, ka konfirmuar se shtetasi Gentian Marku ka llogari page pranë kësaj banke, me gjendje në vlerën 40.168,63 lekë, në datën 10.1.2017.

8.3 Trupi gjykues, në referim të konfirmimit të dërguar nga “Raiffeisen Bank”, konkludoi se deklarimi i subjektit ishte i saktë pasi përputhej me konfirmimin bankar.

9. Llogari rrjedhëse nr. * , në “Credins Bank”,** çelur në vitin 2012. Të hyra në këtë llogari në datën 2.8.2013 në shumën 5.732.000 lekë nga shoqëria e sigurimit “***” për llogari të shtetasve Gj. Z., R.Z. dhe D. Z., shumë e cila është marrë tërësisht nga këta shtetas. Mbyllur llogaria në datën 25.7.2016. Gjendja në llogari në datën e mbylljes është në vlerën 38,04 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

9.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga DPPP-ja”*.

9.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “Credins Bank⁴⁹”, i rezultoi se në llogarinë bankare të subjektit është transferuar në total shuma 5.731.514 lekë në vitin 2013.

9.3 Nga përshkrimi i transaksioneve, Komisioni ka konstatuar se këto shuma janë likuidime nga shoqëria e sigurimit për shtetasit Gj. Z., R. Z. dhe D. Z. . Edhe nga dokumentacioni i administruar konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në kohën që ka qenë (ka ushtruar funksionin e avokatit) avokat⁵⁰ ka pasur tagrin e përfaqësuesit ligjor⁵¹ të këtyre shtetasve për shkak të aksidentit që i ka ndodhur, në marrëdhënien me shoqërinë e sigurimit “***”, me objekt “shpërblim i dëmit pasuror dhe jopasuror”. Nga aktmarrëveshja⁵² e administruar në praktikën takuese të kësaj çështjeje vërehet se palët janë dakordësuar mes tyre për ta zgjidhur çështjen me pajtim, duke u tërhequr kështu nga procesi gjyqësor dhe, për pasojë, kanë përfituar vullnetarisht shumën nga kompania në llogaritë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, në dokumentacionin e administruar gjendet edhe deklarata e këtyre shtetasve, sipas të cilës konfirmohet marrja e shumave, si dhe fakti që nuk kanë asnjë kundërshtim apo problematikë me subjektin e rivlerësimit si përfaqësues i tyre ligjor deri në marrjen e shumave.

9.4 Trupi gjykues, referuar dokumentacionit bankar, shpjegimeve të subjektit, si dhe rolit dhe pozitës së tij në këtë çështje, konkludon se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin

⁴⁷Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

⁴⁸Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 18.8.2020.

⁵⁰Me licencë nr. *** , referuar në prokurën e posaçme nr. *** , datë 23.7.2012 dhe nr. *** , datë 21.12.2012.

⁵¹Me prokurën e posaçme nr. *** , datë 23.7.2012 dhe nr. *** , datë 21.12.2012.

⁵²Aktmarrëveshja nr. *** , datë 15.5.2013, depozituar në aneksin nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së.

e administruar dhe se nuk ngrihen dyshime lidhur me veprimet e ndërsjella të palëve, me qëllim favorizimin e subjektit të rivlerësimit.

9.5 Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka mbajtur korrespondencë edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat, në përgjigjet⁵³ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shtetasit Gj. Z., R. Z. dhe D. Z. .

- Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

Detyrime financiare

10. Apartament banimi me qira, me tri dhoma, në datën 28.10.2016, për një vit. Afati 1-vjeçar ka filluar në datën 15.10.2016, me detyrim në vlerën 15.000 lekë/muaj. Forma e kontratës së qirasë: shkresë e thjeshtë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

10.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Lezhë”*.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

10.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë marrëdhënie qiraje në DPV-në e vitit 2016, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” me përshkrimin: *“Apartament banimi me qira 3 dhoma, në datën 28.10.2016 për një vit. Afati 1-vjeçar ka filluar në datën 15.10.2016. Forma e kontratës së qirasë: shkresë e thjeshtë. Detyrimi është mujor në shumën 15.000 lekë/muaj”*.

10.3 Gjatë hetimit⁵⁴ subjekti ka deklaruar adresat e tij të banimit dhe për apartamentin e marrë me qira ka saktësuar: *“Shtëpi banimi me qira në pasurinë e paluajtshme nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë: lagjja ‘***’, Bashkia Lezhë, e cila sipas vërtetimit hipotekor nr. ***, datë 25.9.2000, është në emër të shtetasve A. dhe D. F. . Kam jetuar me qira nga data 29.9.2016 deri në datën 16.9.2017 (data e blerjes së shtëpisë së banimit nga shtetasi D. G.). Vlera e qirasë ka qenë në shumën 15.000 lekë/muaj. Marrëveshja e qirasë është lidhur me shkresë të thjeshtë dhe kjo shumë i është paguar cash shtetasit N. F. (babai i shtetasve A. dhe D. F.)”*.

10.4 Komisioni, nga analizimi i deklaratës për dhënie objekti me qira⁵⁵, datë 28.10.2016, ka konstatuar paraprakisht se, sa i përket formës së aktit është një deklaratë e thjeshtë jo noteriale, e nënshkruar nga shtetasit A. F. dhe D. F. (qiradhënësit), të cilët i kanë dhënë me qira subjektit tri dhoma, korridor, tualet, për të jetuar së bashku me familjen e tij, për një afat 1-vjeçar, me vlerën 15.000 lekë/muaj.

10.5 ZVRPP-ja Lezhë,⁵⁶ me e-mail-in e datës 20.9.2018, ka konfirmuar se pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 25.9.2000, është në emër të shtetasve A.F. dhe D.F. .

10.6 Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit lidhur me raportin e krijuar me qiradhënësit, Komisioni ka mbajtur korrespondencë edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat, në përgjigjet⁵⁷ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shtetasit A.F. dhe D. F. .

⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; shkresë nr. ***prot., datë 2.12.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; dhe shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2021, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

⁵⁴Pyetësor nr. 1 datë 9.1.2020.

⁵⁵Aneks nr. 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁶Aneks nr. 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; dhe shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2021, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

10.7 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, nuk konstatoi problematika lidhur me këtë çështje.

Deklarim i pasurive të bashkëshortes së subjektit

11. Tokë arë me sipërfaqe totale 16.500 m², e fituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991, e ndodhur në fshatin F., Lezhë, sipas AMTP-së nr. *** akti, datë 1.9.1993. Akti i marrjes së tokës në pronësi në emër të babait G. Gj. Gj., i regjistruar në ZVRPP-në Lezhë në vitin 2012. Pjesa takuese: 20 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

11.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Lezhë”*.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

11.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2015, me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

11.3 Komisioni verifikoi origjinën e pronës, bazuar në dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja⁵⁸, depozituar nga subjekti me deklaratën *Vetting*. Nga verifikimi rezultoi se me AMTP-në nr. *** akti, datë 1.9.1993, fshati F., rrethi Lezhë, shtetasit G. Gj. Gj. i është dhënë në pronësi tokë arë, me sipërfaqe totale 16.500 m².

Sipas AMTP-së kjo sipërfaqe është e përbërë nga disa ngastra:

- nr. ***, me sip. 4900 m²;
- nr. ***, me sip. 1600 m²;
- nr. ***, me sip. 4200 m²;
- nr. ***, me sip. 5800 m².

11.4 Nga verifikimi i certifikatës familjare⁵⁹, datë 17.1.2017, e lëshuar me qëllim vërtetimin e gjendjes familjare të datës 1.8.1991, me kryefamiljar G.Gj., konfirmohet se bashkëshortja e subjektit është e bija e këtij shtetasi.

11.5 Subjekti është pyetur⁶⁰ lidhur me faktin se në aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. *** akti, datë 1.9.1993, rezulton si përfitues shtetasi me emër G. Gj. Gj., ndërsa në deklaratën *Vetting* për këtë pasuri parashikohet se akti i marrjes së tokës në pronësi është në emër të G.Gj. Gj. . Në vijim është kërkuar dokumentacion provues.

11.5.i Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e dhënë, ka shpjeguar se: *“Akti i marrjes së tokës në pronësi (në vijim: AMTP) nr. *** është përpiluar në datën 1 shtator 1993 në emër të kryefamiljarit G. Gj. Gj., nga fshati F. . Emri në AMTP është shkruar me atë emër (të shkurtuar) që thirret në jetën e përditshme vjehri im ‘G.’ dhe jo ‘G.’, sikurse rezulton në aktet e gjendjes civile. Ky gabim material në AMTP lidhet me kohën e përpilimit të AMTP-së, mosreferimi i Komisionit të Ndarjes së Tokës së Fshatit në aktet zyrtare të gjendjes civile, por, duke u mjaftuar vetëm me njohjen personale për shkak të të qenit banorë të të njëjtit fshat, qoftë të anëtarëve të Komisionit të Ndarjes së Tokës dhe të përfituesit të AMTP-së”*.

Në funksion të këtij pohimi se përbën gabim material, subjekt ka vënë në dispozicion vërtetimin datë 28.6.2012, të lëshuar nga kryetari i Komunës B., sot Njësia Administrative B. .

Nga verifikimi i aktit shihet se ky institucion vërteton faktin se shtetasi G. Gj., i datëlindjes 15.1.1954, është i njëjti person me shtetasin G.Gj., të po kësaj datëlindjeje.

⁵⁸Aneks nr. 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁹Aneks nr. 4/11, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁰Me pyetësorin nr. 3, datë 9.11.2021.

11.6 Në analizë për sa më sipër, ku konstatohet se përmbushen kriteret përkatëse për të qenë subjekti përfitues i pasurisë së deklaruar, sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, referuar edhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të depozituar, trupi gjykues konkludon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi këtë pasuri dhe se nuk vërehen problematika lidhur me përfitimin e saj.

12. Depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”, çelur në datën 27.10.2016. Afati i depozitës: 30 muaj. Data e maturimit të depozitës 29.4.2019. Norma e interesit: për vitin e parë 1,10 %; për vitin e dytë 1,70%; dhe për 6-mujorin e fundit 2,55%. Burimi i krijimit: shitja e apartamentit nr. ***, me sip. 69.05 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, shtetasit A.P., në datën 29.9.2016. Vlera: 3.100.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.

12.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ‘Intesa Sanpaolo Bank’”*.

12.2 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2020, ka informuar Komisionin se bashkëshortja e subjektit D. M. disponon depozitë me afat në vlerën 3.100.000 lekë.

Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se burim krijimi për këtë depozitë janë të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit nr. ***, me sip. 69.05 m², shtetasit A. P., në datën 29.9.2016.

12.3 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, konkludoi se përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank” për vlerën e kësaj depozite.

13. Depozitë në “ProCredit Bank”, çelur në datën 6.8.2015. Afati i depozitës: 12 muaj. Shuma e interesit vjetor: 1,7%. Rinovuar kontrata në datën 6.8.2016 deri më 6.8.2017, me interes 1%. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga si mësuese. Vlera: 341.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶¹.

13.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ‘ProCredit Bank’”*.

13.2 “ProCredit Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 18.5.2020, ka informuar Komisionin se bashkëshortja e subjektit D. M. disponon depozitën me afat në vlerën 341.000 lekë.

13.3 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, konkludoi se përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e ardhur nga “ProCredit Bank” për vlerën e kësaj depozite.

14. Kontratë shërbimi përkthimi me W. V. A., dega Lezhë, viti 2014, përfituar vlera 100.090,90 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës “marrëveshje për kryerjen e shërbimeve nga kontraktorë të pavarur, datë 3.12.2014, me punëdhënësin W.V. A. dhe D. M.”⁶².

14.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar”*.

14.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se bashkëshortja e subjektit e ka deklaruar për herë të parë këtë kontratë shërbimi në DPV-në e vitit 2014, në rubrikën e të dhënave konfidenciale me përshkrimin “marrëveshje për kryerjen e shërbimeve nga kontraktorë të pavarur ndërmjet W. V. A., NIPT *** dhe D. M. me objekt: përkthime korrespondencë rutinë,

⁶¹Kontratë datë 6.8.2015, për depozitë bankare në “ProCredit Bank”, në emër të shtetases D. M. . Vërtetim për depozitën me afat 1-vjeçar, të vlerës 341.000 lekë, në emër të shtetases D.M.(aneks nr. 4/13, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶²Aneks nr. 4/14, në dosjen e ILDKPKI-së.

përkthime APR, përkthime CH (*Christmas card*), nga data 3.12.2014 – 30.9.2015. Pagesa do të bëhet pas kryerjes së shërbimit”.

14.3 Gjatë hetimit rezultoi se në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit D. M. në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 21.7.2015 është kredituar shuma 100.090,9 lekë nga W.V. A., me përshkrimin “likuiduar D. M. përkthyes zyra Lezhë”.

14.4 Trupi gjykues, nisur nga faktet e prezantuara nga subjekti, rrethanat e rezultuara gjatë hetimit, si dhe nga dokumentacioni i administruar, konkludoi se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi të ardhurat e përfituara nëpërmjet kontratës përkatëse të shërbimit.

15. Llogari kursimi në vlerën 285,16 lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”, me gjendje në llogari në datën 17.1.2017. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶³.

15.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: “*Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ‘Intesa Sanpaolo Bank’*”.

15.2 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2020, ka informuar Komisionin se bashkëshortja e subjektit D. M. disponon llogari pranë kësaj banke në vlerën 285,16 lekë, në datën 24.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*.

15.3 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, konkludoi se përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

16. Llogari kursimi në vlerën 24.802,36 lekë në “ProCredit Bank”, çelur në datën 8.9.2015, me gjendje në llogari në datën 12.1.2017. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga që kalojnë nga llogaria rrjedhëse në këtë llogari. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁴.

16.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: “*Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ‘ProCredit Bank’*”.

16.2 “ProCredit Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2020, ka informuar Komisionin se bashkëshortja e subjektit D. M. disponon llogari kursimi pranë kësaj banke në vlerën 24.802,36 lekë, në datën 24.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*.

16.3 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, konkludoi se përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e ardhur nga “ProCredit Bank” për vlerën e kësaj llogarie kursimi.

17. Llogari rrjedhëse në vlerën 48.583,49 në “ProCredit Bank”, çelur në datën 28.2.2008, me gjendje në llogari në datën 12.1.2017. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga si mësuese. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁵.

17.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: “*Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ‘ProCredit Bank’*”.

17.2 “ProCredit Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 18.5.2020. ka informuar Komisionin se bashkëshortja e subjektit D. M. disponon llogari pranë kësaj banke në vlerën 48.583,49 lekë, në datën 24.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*.

⁶³Vërtetim llogarie datë 17.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, e cila konfirmon se në emër të shtetases D. M. ka llogari kursimi në vlerën 285 lekë. Nxjerrje llogari bankare (aneks nr. 4/12, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶⁴Kontratë për depozitë bankare datë 8.9.2015, pranë “ProCredit Bank”, në emër të shtetases D.M. . Gjendja e llogarisë së kursimit në datën 12.1.2017 është në vlerën 24.802 lekë (aneks nr. 4/15, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶⁵Nxjerrje llogari page, datë 12.1.2017, nga “ProCredit Bank”, në emër të shtetases D.M., me gjendje në vlerën 48.583 lekë. Vërtetim datë 12.1.2017, interesa nga depozita në “ProCredit Bank”, në vlerën totale 1.005 lekë (aneks nr. 4/16, në dosjen e ILDKPKI-së).

17.3 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, konkludoi se përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e ardhur nga “ProCredit Bank” për vlerën e kësaj llogarie.

18. Depozitë në “Alpha Bank”, çelur në vitin 2008 dhe e mbyllur në datën 29.10.2015. Gjendja në llogari në datën e mbylljes: 2.873,59 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga pagat. Vlera: 670.500 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁶.

18.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ‘Alpha Bank’”*.

18.2 “Alpha Bank”, me shkresën nr*** prot., datë 4.5.2020, ka informuar Komisionin mbi depozitën që ka disponuar bashkëshortja e subjektit D. M. . Ashtu siç deklarohet, kjo depozitë është mbyllur në vitin 2015 dhe nuk disponohet në momentin e deklaratës *Vetting*.

18.3 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, konkludoi se përputhet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Alpha Bank”.

19. Të tjera

19.1 Nga analizimi i korrespondencave me institucionet publike⁶⁷ si AMF, Policia e Shtetit (për hyrje-daljet) dhe Ministria e Drejtësisë (për regjistrin noterial), trupi gjykues ka konkluduar se nuk kanë rezultuar problematika apo dyshime për përdorim automjetesh, dalje në sistemin *TIMS* me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkuara pranë noterit publik nga dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit.

Në konkluzion për rivlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre dhe se konkludimi i arritur pas arsyetimit në pikën nr. 7 të vendimit, proporcionalisht dhe objektivisht në tërësi të vlerësimit të këtij kriteri, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e ndonjë mase disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ndaj subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr***prot., datë 21.11.2017, mbi kontrollin e figurës, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 27.10.2020, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Gentian Marku*.

2. Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në

⁶⁶Librezë kursimesh pranë “Alpha Bank”, në emër të shtetases D. M., me gjendje në vlerën 671.958 lekë, në datën 11.6.2010. Nxjerrje llogarie nga “Alpha Bank”, datë 29.10.2015, me gjendje 0 (zero) lekë (aneks nr. 4/17, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶⁷Shkresat: nr. ***prot., datë 19.10.2021, e AMF-së; nr. *** prot., datë 11.5.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; nr. *** prot., datë 8.5.2020, e Ministrisë së Drejtësisë.

mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

3. Për sa kohë që nga hetimi⁶⁸ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjyqësor arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Gentian Marku ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti⁶⁹ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve nga raporti i vlerësimit të aftësive profesionale, hartuar nga grupi përkatës i punës, i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short⁷⁰; si dhe (iv) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ⁷¹.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

⁶⁸Me shkresën nr. ***prot., datë 16.4.2021.

⁶⁹Raport nr. ***prot., datë 25.5.2021.

⁷⁰Dosja 1 – çështja penale nr. ***regj., datë 5.3.2015, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë kundër të pandehurit T. M., i akuzuar për veprën penale “drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 12.5.2015; dosja 2 – çështja penale nr. *** regj., datë 3.12.2014, që i përket të pandehurit A. M., i akuzuar për veprën penale “dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 5.2.2015; dosja 3 – çështja civile nr. *** regj., datë 25.3.2014, që i përket paditësit Xh. T., të paditur L. B., D. B., etj., me objekt “lirim dhe dorëzim të pasurisë 2030 m² tokë arë në fshatin Z., Lezhë”, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 4.5.2015; dosja 4 – çështja civile nr.*** regj., datë 13.11.2014, që i përket paditësit T. B., kundër të paditurit DRSSH Lezhë, me objekt “njohjen e vërtetësisë së dokumentit...”, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 11.12.2014; dosja 5 – çështja administrativo-penale nr. *** regj., datë 8.1.2015, që i përket kërkuarit A. M., me objekt “ulje dënimi penal”, parashikuar në nenin 63, të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 26.1.2015.

⁷¹Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Gentian Marku janë paraqitur gjithsej 2 ankesa (1 në vitin 2015, 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së. Ankesa e vitit 2015 është arkivuar me arsyetimin se pretendimet për zvarritje gjykimi nuk janë të bazuara, ndërsa pretendimet për ligjshmërinë e vendimit zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. Ankesa e vitit 2016, e cila është informacion periodik nga kryetari i gjykatës, verifikuar për fillimin e seancave me vonesë, nuk është përfunduar procesi i verifikimit nga inspektorët dhe me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kjo praktikë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni, me shkresën përcjellëse nr.***prot., datë 6.7.2020, shoqëruar me procesverbalin nr. *** prot., datë 28.7.2020. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Gentian Marku përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Subjekti i rivlerësimit Gentian Marku ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë. Në shume raste, në funksion të zbatimit të ligjit, ai përdor referenca nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudenca e Gjykatës së Lartë.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet penale i kushton rëndësi të gjithë elementeve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes te kriteret ligjore në shqyrtimin e kërkesave administrative penale.

Ka njohuri të procedurave të gjykimit, në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar katër prej tyre. Në të katër rastet, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, ndërsa në katër rastet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Gentian Marku ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe i përdor gjithmonë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila, kur është rasti, plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese. Një tipar i mirë i punës së tij është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke përdorur edhe çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendimi nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët.

Gjithashtu, tek të pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se i kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Gentian Marku, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer për afro një vit detyrën e gjyqtarit stazhier në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, njëkohësisht në dhomën civile e penale.

Ai ka deklaruar se gjatë vitit të stazhit i janë caktuar gjithsej 470 çështje, ka përfunduar 457 prej tyre, si dhe ka mbartur në fund 13 çështje të vitit 2015. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 97,2 %.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Gentian Marku ka qenë gjithnjë brenda afateve standard apo ligjor dhe në intervale kohore nga 17 ditë deri në 5 muaj e 28 ditë. Në tri dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 2 muaj e 1 ditë, 2 muaj dhe 28 ditë. Nga pesë dosje të vëzhguara është konstatuar se në pesë dosjet është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor.

Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve, në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit rezulton se kohëzgjatja e gjykimit për çështjen e parë administrativo-penale është 1 muaj e 9 ditë, për çështjen e dytë civile themeli është 4 muaj e 2 ditë dhe për çështjen e tretë penale themeli afati është 6 muaj e 26 ditë. Në tri dokumentet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtari Gentian Marku ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore dhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Gentian Marku dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Gentian Marku. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Gentian Marku nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Gentian Marku komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit dhe as kërkesa të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Gentian Marku për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të 8 raste, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar i vetëm për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Gentian Marku, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ai ka marrë pjesë në 9 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 14 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale. Subjekti i rivlerësimit Gentian Marku ka deklaruar në formular se nuk ka marrë pjesë në aktivitete të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

C/1. RIVLERËSIMI PROFESIONAL

a) Komisionit, më lidhje me analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në tërësi nuk i rezultuan problematika në lidhje me tri dokumentet ligjore, të llojit vendim gjyqësor, si dhe në pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short. Komisioni, nga tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara ka konkluduar se vendimet e hartuara nga subjekti nga pikëpamja e strukturës, janë ndërtuar me paragrafë, sipas analizës së çështjes. Rregullat e drejtshkrimin janë respektuar dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Përgjithësisht vendimet paraqiten të standardizuara në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës.

Gjithashtu, Komisionit, sikurse i ka rezultuar edhe KLGJ-së në raportin e saj, i rezultoi se subjekti në arsyetimin e vendimeve përmend dhe analizon rast pas rasti norma të Kushtetutës, Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, KEDNJ-së, ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë” dhe ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Po ashtu vërehet se subjekti i rivlerësimit ka përdorur shprehimisht parime të së drejtës si “legjitimitimi aktiv”, “funksioni publik kushtetues” dhe “funksioni privat kushtetues”.

b) Pavarësisht sa më sipër, Komisionit, sikurse i ka rezultuar edhe KLGJ-së në raportin e saj, i rezultoi se:

i) Vendimi që i përket dosjes nr. 1 tek pesë dosjet e përzgjedhura me short është depozituar në kryesekretari nga subjekti në datën 5.6.2015 – pas 23 ditëve nga shpallja, pra, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

ii) Në aktet e dosjes nr. 2, që i përket pesë dosjeve të përzgjedhura me short, nuk pasqyrohet data se kur është dorëzuar në kryesekretari dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar nga subjekti.

iii) Në aktet e dosjes nr. 3, që i përket pesë dosjeve të përzgjedhura me short, nuk pasqyrohet data se kur është dorëzuar në kryesekretari dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar nga subjekti.

iv) Në rubrikën që i përket të dhënave arkivore, parashikohej se ishte depozituar një ankesë e vitit 2016 në adresë të subjektit të rivlerësimit, si informacion periodik nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, verifikuar për fillimin e seancave me vonesë, procesi i verifikimit të të cilës sipas raportit profesional nuk është përfunduar nga inspektorët dhe, në vijim, citohej se

me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kjo praktikë i ishte dërguar për kompetencë këtij institucioni, me shkresën përcjellëse nr. ***prot., datë 6.7.2020, shoqëruar me procesverbalin nr. ***prot., datë 28.7.2020.

Komisioni mbajti korrespondencë me ILD-në për të mësuar mbi ecurinë e procesit të verifikimit të informacionit të dhënë nga kryetari i gjykatës. Ky institucion⁷² përcolli praktikën e plotë lidhur me trajtimin e ankesës dhe njëkohësisht bëri me dije se deri aktualisht praktika është e regjistruar pranë zyrës së ILD-së me nr***prot., datë 5.2.2021 dhe se vijon të ndodhet në fazën e shqyrtimit të saj. Nga analizimi i praktikës Komisioni vëren se është mbajtur një procesverbal i inspektorit të KLD-së (sot ILD) bazuar në urdhrin e nxjerrë për verifikimin e ankesës së bërë prezent nga kryetari i gjykatës dhënë në informacionin periodik. Nga procesverbali i mbajtur, Komisioni vëren gjithashtu se subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me vonesat e konstatuara për fillimin e procesit gjyqësor në tri raste, krahasuar me orën e caktuar për zhvillimin e tyre dhe për këtë qëllim ka dhënë përgjigje. Në përgjigjet e dhëna subjekti ka identifikuar minutazhet e tejkaluara për fillimin e procesit gjyqësor krahasuar me oraret e caktuara për t'u zhvilluar. Referuar praktikës rezultoi se në të janë administruar edhe procesverbalet e seancave gjyqësore për të cilat subjekti është pyetur dhe ka dhënë përgjigje.

- Për sa u konstatua në pikat b.i, b.ii, b.iii dhe b.iv, më lart, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës.

c) Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

i) Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij⁷³, ndër të tjera, për konstatimin lidhur me pesë dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short, mbajti qëndrimin se:

Sa i përket dosjes nr. 1, subjekti ka pretenduar se: *“Dorëzimi i vendimit gjyqësor 23 ditë pas shpalljes së vendimit gjyqësor është rrjedhojë e mbingarkesës që ka pasur në punë si gjyqtar stazhier në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Gjatë kësaj periudhe është shortuar dhe ka gjykuar me ngarkesë të plotë prej 100 %, njësoj sikurse edhe gjyqtarët e tjerë të asaj gjykate, duke gjykuar të gjitha llojet e çështjeve, pavarësisht kompleksitetit. Ngarkesa e plotë dhe natyra komplekse e çështjeve të shortuara përgjatë periudhës së stazhit profesional ka sjellë që të ishte objektivisht në pamundësi për dorëzimin në sekretari të vendimit brenda afatit ligjor 5-ditor.”* Subjekti ka sqaruar se për periudhën 31.10.2014 – 11.7.2015 ka ushtruar detyrën si gjyqtar stazhier në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Në mbështetje të pretendimeve ka paraqitur përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë⁷⁴, ku evidentohet ngarkesa e plotë e tij në punë, si dhe lloji i çështjeve gjyqësore. Subjekti ka depozituar edhe informacion⁷⁵ mbi numrin e çështjeve të shortuara dhe historikun e çështjeve që i janë caktuar për periudhën e sipërcituar. Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se në referim të legjislacionit specifik⁷⁶ të kësaj fushe duhej që gjatë stazhit profesional të gjykonte vetëm çështje më pak të komplikuar dhe gjithnjë nën udhëheqjen e një gjyqtari më me eksperiencë, ndërsa ai ka gjykuar njëjtë me gjyqtarët e tjerë. Subjekti ka pretenduar se: *“Dorëzimi i një vendimi tej afatit 5-ditor, por brenda atij 30-ditor, nuk është konsideruar në asnjë rast shkelje as nga ana e KLD-së, KLGJ-së dhe as nga organet e rivlerësimit kalimtar”.*

Sa i përket dosjeve nr. 2 dhe nr. 3, të pesë dosjeve të përzgjedhura me short, subjekti ka paraqitur të njëjtat pretendime dhe argumente për të dyja, duke referuar sërish përgjigjen e

⁷²Me shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2021.

⁷³Datë 29.12.2021.

⁷⁴Me shkresën nr*** prot., datë 23.12.2021.

⁷⁵Raportet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, të dërguar me shkresën përcjellëse nr*** prot., datë 23.12.2021.

⁷⁶Germa “c”, e nenit 14, të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 23 të “Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës”, e miratuar nga Këshilli Drejtues sipas vendimit nr. ***, datë 19.6.2007.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku citohet se: “Nuk disponohen të dhëna mbi datën e dorëzimit të këtyre çështjeve, duke qenë se nga kryesekretari i asaj periudhe kohore nuk rezulton që të jenë dokumentuar me libër dorëzimi datat se kur janë dorëzuar në kryesekretari dhe se ky punonjës në kohën që ka ushtruar detyrën e kryesekretarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, është proceduar penalisht për veprën penale ‘shpërdorim detyre’, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”. Subjekti, ka bashkëlidhur vendimet përkatëse. Gjithashtu ka pretenduar se konstatimi i Komisionit ka lidhje me administrimin e dosjeve gjyqësore nga ana e administratës gjyqësore dhe se gjyqtari është i përjashtuar nga kjo veprimtari dhe përgjegjësi, referuar neneve 38 dhe 39⁷⁷ të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

ii) Subjekti, në parashtrimet e tij lidhur me ankesën për fillimin e seancave me vonesë, ka sqaruar se bëhet fjalë për tre seanca gjyqësore të zhvilluara në të njëjtën datë (26.8.2021) dhe në mënyrë të njëpasnjëshme. Gjithashtu ka dhënë shpjegime lidhur me objektin për secilën prej tyre, intervalet e vonesave, si dhe ka sqaruar arsyet e vonesave.

Sa më sipër, trupi gjykues, lidhur me dosjet nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, nga pesë dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe provave të depozituara prej tij, duke vlerësuar se janë të plota dhe të argumentuara, çmon se nuk u konstatuan problematika që cenojnë vlerësimin profesional të tij.

Gjithashtu, trupi gjykues, lidhur me ankesën, duke marrë parasysh se: (i) intervalet e vonesave midis seancave ishin të shkurtra në kohë dhe varionin nga 2-6 minuta; (ii) shkaqet e vonesave janë arsyetuar nga subjekti referuar në çdo rast objektit të shqyrtimit; (iii) nuk rezultoi që vonesat të kenë sjellë pasoja në mbarëvajtjen e seancave; si dhe (iv) duke marrë parasysh praktikën e përcjellë nga ILD-ja me shkresën nr*** prot., datë 20.10.2021 (e cila ka informuar se çështja vijon të ndodhet në fazën e shqyrtimit të saj), çmon se pretendimet e subjektit dhe rrethanat e konstatuara janë bindëse dhe nuk përbëjnë problematika në kuadër të vlerësimit profesional.

DENONCIMET

Në lidhje me 6 denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar si vijon:

Pas shqyrtimit në tërësi të denoncimeve, për dy prej tyre të paraqitura, përkatësisht nga shtetasit S. Ç.⁷⁸ dhe H. Gj.⁷⁹, nuk u konkluduan fakte apo rrethana të cilat mund të ndikonin në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Denoncimi i shtetasit R. H.⁸⁰ u depozitua në rrugë elektronike nëpërmjet *e-mail-it* zyrtar të Komisionit, pas procesit për vendimmarrjen e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues, pas konstatimeve se pretendimet e denoncuesit sipas përmbajtjes së denoncimit: (i) i përkisnin themelit të çështjes; (ii) denoncimi nuk kishte bashkëlidhur dokumentacion provues; (iii) çështja, sipas denoncuesit, ishte për gjykim në gjykatën e apelit; si dhe (iv) nuk impaktonte subjektin në kriterin e vlerësimit profesional, vlerësoi që ky denoncim të mos trajtohej.

⁷⁷Neni 38/c citon: “Kancelari i gjykatës ka këto kompetenca kryesore: (c) ndjek ecurinë e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara në sekretarinë gjyqësore, në përputhje me afatet procedurale të parashikuara në ligj”; neni 39 citon: “Shërbimet ndihmëse në gjykatë kryhen nga sekretaria gjyqësore, degët dhe sektorët e administratës, të ekonomisë, financës, informatizimit, regjistrimit dhe ruajtjes së dokumenteve”.

⁷⁸Denoncim nr. *** prot., datë 6.3.2019.

⁷⁹Denoncim nr. *** prot., datë 23.12.2019.

⁸⁰Dërguar në rrugë elektronike në *e-mail-in* zyrtar të Komisionit në datën 26.1.2022.

Komisioni u ndal tek 3 denoncime të shtjelluara në vijim, për të cilat i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacionin provues. Më konkretisht:

1. Denoncim⁸¹ i shtetases L. D.

1.1 Kjo shtetase (me profesion mësuese) ankohet për proces jo të rregullt ligjor ndaj disa gjyqtarëve, ndër të cilët edhe subjekti i rivlerësimit. Kryesisht pretendimet në denoncim i referohen një subjekti tjetër rivlerësimi me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

1.2 Problematikat e pretenduara nga denoncuesja lidhen me mospunësimin e saj si mësuese sipas legjislacionit në fushën e arsimit parauniversitar. Fillimisht ajo pretendon se ka bërë një kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me palë të paditura DAR Shkodër dhe MASR. Lidhur me këtë gjykim, me gjyqtar një subjekt tjetër (V. D.), denoncuesja pretendon se padia është kthyer për plotësim të metash, është realizuar seanca përgatitore, është vazhduar me procedurën e mbledhjes së provave nga gjykata dhe pas katër seancash gjyqtari ka vendosur mospranimin e padisë, duke dhënë edhe argumentet përkatëse, ndër të tjera, edhe faktin që çështja nuk është administrative por civile, me argumentin se konfliktet e punës zgjidhen me Kodin e Punës. Në vijim, denoncuesja ka ngritur një padi civile pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe me short është përcaktuar një gjyqtar tjetër (A. Ll.), subjekt tjetër. Më pas denoncuesja e ka tërhequr padinë dhe ka ngritur një padi të re, ku përcaktohet po i njëjti gjyqtar, subjekt tjetër, i cili më pas ka hequr dorë nga gjykimi (kërkesë që i është pranuar nga kryetari i gjykatës). Padia është rihedhur në short dhe çështja i ka kaluar për gjykim një gjyqtari tjetër (A. Y.), i cili shpalli moskompetencën, duke arsyetuar se çështja është administrative dhe jo civile.

Më pas çështja kalon në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe me short përcaktohet që të gjykohet nga subjekti i rivlerësimit.

1.3 Denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit: (i) kërkesëpadinë datë 24.1.2018, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me palë të paditura Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Shkodër (DAR); (ii) vendimin nr. ***, datë 31.5.2018⁸², të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ku është vendosur mospranimi i padisë, me të drejtë ankimi brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në këtë gjykatë; (iii) korrespondencën dhe aktet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shkresa të DAR Shkodër; (iv) kërkesën e denoncueses drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me gjyqtar një subjekt tjetër rivlerësimi; si dhe (v) kërkesën drejtuar DAR Shkodër.

1.4 Denoncuesja pretendon ndaj subjektit se që në seancën e parë ka vendosur të pushojë çështjen gjyqësore, me pretendimin se çështja është në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë (me kërkesë të palës së paditur). Në vijim denoncuesja pretendon se padia lidhur me çështjen në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë ishte e ndryshme nga padia në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, pasi paraqiteshin prova të reja dhe palë e re e paditur (Komisioni i Vlerësimit). Gjithashtu ajo pretendon se në shkelje të procedurave nuk i janë vënë në dispozicion për njohje kërkesa me shkrim dhe provat e paraqitura nga pala tjetër, por i ka kërkuar pas seance dhe i ka marrë nga gjykata pasi procesi ishte mbyllur.

1.5 Denoncuesja nuk ka evidentuar nëse ka bërë ankim ndaj këtij vendimi dhe nuk ka depozituar kopje të tij.

⁸¹Denoncim nr. *** prot., datë 25.3.2019, ridërguar në *e-mail*-in zyrtar të Komisionit në datën 6.1.2022.

⁸²Vendimi i parë gjyqësor nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, i marrë nga një subjekt tjetër.

1.6 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi pretendimet e denoncuesit lidhur me procesin dhe vendimmarrjen e tij, mbi statusin e çështjes që rezultoi me vendimin e pushimit nga subjekti, si dhe të depozitonte dokumentacionin përkatës në mbështetje të shpjegimeve.

1.7 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar si vijon:

a) Lidhur me pretendimin e denoncueses se vendimi i pushimit ishte jo i drejtë, pasi padia e paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (me gjyqtar subjektin) ishte e ndryshme nga padia lidhur me çështjen në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, pasi objekti i padisë paraqitej një palë e re e paditur dhe paraqiteshin prova të reja, subjekti ka dhënë fillimisht informacion të përgjithshëm mbi çështjen, duke sqaruar se denoncuesja ka pasur cilësinë procedurale të paditëses në çështjen gjyqësore të gjykuar prej tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, se kërkesëpadija ishte regjistruar në datën 23.10.2018, me palë të paditura Ministria e Arsimit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër dhe palë e interesuar Avokatura e Shtetit (Zyra Vendore Shkodër). Në bazë të shortit elektronik ishte përzgjedhur subjekti për shqyrtimin e kësaj çështjeje gjyqësore.

Subjekti pretendoi se në seancën përgatitore ka konstatuar se një trupë tjetër gjyqësore e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër kishte shqyrtuar një kërkesëpadi me të njëjtat palë ndërgjyqëse dhe me të njëjtin objekt gjykimi, për të cilën ishte vendosur mospranimi i padisë së denoncueses, duke evidentuar vendimin nr. ***, datë 31.5.2018 të kësaj gjykate. Subjekti ka sqaruar se denoncuesja (paditësja) ndaj këtij vendimi kishte ushtruar të drejtën e ankimit të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr***, datë 11.2.2019, kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 31.5.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Më tej, ai ka sqaruar se kjo çështje aktualisht ndodhej në Gjykatën e Lartë, pas rekursit të bërë prej denoncueses.

Sa më sipër, lidhur me vendimmarrjen e tij, ka sqaruar se i ndodhur në kushtet kur në kohën e shqyrtimit të çështjes prej tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ndodhej për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë ankimi i veçantë i paditëses ndaj vendimit nr. ***, datë 31.5.2018, të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Shkodër, me të njëjtët palë dhe të njëjtin objekt padie, atëherë ai kishte vendosur me vendimin nr. ***, datë 11.12.2018, pushimin e gjykimit, sipas nenit 58 të Kodit të Procedurës Civile⁸³.

Sa i përket pretendimit të denoncuese se kishte paraqitur prova të reja në gjykim, subjekti ka deklaruar se: *“Kjo nuk përbën argument për gjykimin dy herë të së njëjtës çështje nga dy gjykata të ndryshme. I vetmi institut i së drejtës civile për rigjykimin e një çështjeje të përfunduar me vendim të formës së prerë është ai i rishikimit gjyqësor. Një vendim gjyqësor kundërshtohet vetëm përmes mjeteve të ankimit dhe nëse ka marrë formë të prerë dhe zbulohen prova të reja që nuk janë ditur, paraqitet kërkesë për rishikim, por asnjëherë nuk lejohet që të paraqitet një padi e re. Parimi i sigurisë juridike nuk mund të lejojë vijimin pa fund të proceseve gjyqësore vetëm sepse njëra nga palët nuk është e kënaqur me vendimmarrjen e gjykatës”. Ndërsa, lidhur me pretendimin se ishte paraqitur një palë të re të paditur, subjekti u shpreh se vlente i njëjti argument.*

b) Lidhur me statusin e vendimit të dhënë prej tij, subjekti ka sqaruar se nga denoncuesja është ushtruar ankim i veçantë dhe se çështja ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për të cilën deri aktualisht është caktuar vetëm relatori i saj. Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka depozituar fletën e printuar nga regjistrimi i çështjes në këtë gjykatë.

⁸³Neni 58 i Kodit të Procedurës Civile citon: *“Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë”.*

Në mbështetje të pretendimeve të tij, në cilësinë e provës, subjekti ka depozituar: (i) vendimin nr. ***, datë 11.12.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë; (ii) vendimin nr. ***, datë 31.5.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër; (iii) vendimin nr. ***, datë 11.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; si dhe (iv) printimin nga faqja elektronike e Gjykatës së Lartë lidhur me statusin e çështjes (ku rezulton studim i çështjes).

1.8 Në analizë të pretendimeve të denoncuesit, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar, trupi gjykues nuk vëren ndonjë rrethanë konkrete në të cilën gjyqtari/subjekti i rivlerësimit të ketë shkelur normat procedurale. Gjithashtu, për sa kohë të dyja çështjet janë aktualisht në proces mbi ankimet e ushtruara, ligjërimi i vendimmarrjes së subjektit është kompetencë e gjykatës së shkallës më të lartë.

2. Denoncim⁸⁴ i shtetasit T. M.

2.1 Ky shtetas pretendon se subjekti ka mungesë profesionalizimi në dhënien e vendimit nr. ***, datë 25.2.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ku denoncuesi rezultoi si paditës, me palë të paditur shtetasin F.M. (vëllai i tij, referuar denoncimit dhe vendimit) dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me objekt padie: *“1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. ***, datë 9.4.2003, të Komisionit të Regjistrimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër; 2. detyrimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, të bëjë çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme të regjistruar në favor të T. M. me të dhëna, pasuri nr***, z. k. ***, me sipërfaqe 280 m², nga të cilat 50 m² janë ndërtesë (shtëpi banimi); 3. detyrimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, të bëjë çregjistrimin nga regjistri i pasurisë së paluajtshme të pasurive të regjistruara në favor të F. M. me të dhëna, pasuri me z. k. ***, me sipërfaqe trualli 269 m², nga kjo sipërfaqe ndërtimore 50 m², pasuri e cila është certifikuar në datën 1.9.2015, me certifikatë për vërtetim pronësie nr*** nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, nr. pasurie ***, volumi ***, faqe***, adresa e pasurisë Shkodër, sipërfaqja totale 269 m², nga kjo 50 m² ndërtesë”*.

2.2 Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit vendimin nr. ***, datë 25.2.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe kopjen e dosjes gjyqësore.

2.3 Pas verifikimit të vendimit, Komisionit i rezultoi se çështja është regjistruar në datën 7/8.2.2019 dhe ka përfunduar së gjykuari në datën 25.2.2020. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 vit e 18 ditë, pra, përtej afatit 6-mujor të përcaktuar nga germa “e” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

2.4 Nga verifikimi i denoncimit dhe dokumentacionit bashkëlidhur, Komisioni konstatoi se pretendimet e denoncuesit lidhen me themelin e gjykimit dhe nuk referojnë në problematika specifike të karakterit profesional, ndërsa lidhur me kohëzgjatjen e këtij gjykimi, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime.

2.5 Subjekti në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar:

a) Sa i përket ecurisë së çështjes, ka sqaruar se aktualisht është në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë mbi ankimin e ushtruar nga denoncuesi/si paditës. Në mbështetje të deklaramentit, subjekti ka depozituar: (i) vendimin nr. ***, datë 25.2.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, të dhënë prej tij; si dhe (ii) fletën e printuar nga regjistrimi i çështjes në këtë gjykatë, datë 15.7.2020.

b) Kohëzgjatja e këtij procesi gjyqësor është kushtëzuar nga disa faktorë/arsye objektive, duke specifikuar: (i) për shkak të transferimit të tij (datë 13.6.2018) në Gjykatën Administrative të

⁸⁴Denoncim nr. *** prot., datë 3.6.2020.

Shkallës së Parë Shkodër i duhej që të vijonte njëkohësisht edhe çështjet të cilat i kishte nisur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, nga ku edhe po transferohej; dhe (ii) se në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ku u transferua, për shkak të urdhrin të brendshëm të drejtuesit të kësaj gjykate i ishin kaluar për gjykim nëpërmjet shortimit manual 177 çështje administrative të viteve të mëparshme, të cilat nuk ishin vënë në lëvizje. Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti ka depozituar urdhrin e brendshëm nr. ***, datë 27.6.2018, “Për kalimin me short manual të çështjeve të pavëna në lëvizje”, të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

2.6 Trupi gjykues, në analizë të arsyeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, duke marrë parasysh me objektivitet edhe rrethanat specifike në këtë rast që lidhen me shërbimin e subjektit në dy gjykata njëkohësisht dhe ngarkesën e çështjeve në gjykim, çmon se argumentet qëndrojnë dhe, si pasojë, nuk mund të përbëjnë shkak për konstatimin e problematikave të karakterit procedural.

3. Denoncimi⁸⁵ i shtetasit Gj. N.

3.1 Ky shtetas ankohet ndaj subjektit lidhur me vendimin penal nr. ***, datë 28.7.2021, të marrë prej tij, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka deklaruar të pafajshëm shtetasin A. B., i cili, sipas denoncuesit, ka shkaktuar aksidentin automobilistik me pasojë vdekjen ndaj shtetasit M.N. (babai i denoncuesit) dhe ka plagosur disa shtetas të tjerë që kanë qenë në automjet të bashku me viktimën.

3.2 Denoncuesi pretendon se subjekti e ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin A. B. edhe pse sipas tij gjatë gjykimit të çështjes është arritur të provohet tej çdo dyshimi se ky shtetas kishte konsumuar plotësisht elementet e veprës penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2/3 të Kodit Penal. Në mbështetje të pretendimeve të tij denoncuesi i referohet “aktekspertimin auto-teknik të datës 4.12.2020”, të kryer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë, për të cilin citon: *“I pandehuri A. B. ka shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, pasi me vetëbesim të tepruar është futur në një vendkalim të rrezikshëm në një rrugë që nuk plotëson asnjë element sigurie...”* dhe “aktekspertimin auto-teknik të datës 13.4.2021”, për të cilin citon: *“Në lidhje me shpejtësinë e mjetit, nga llogaritjet ka rezultuar se shpejtësia kritike në kthesë është e rendit 15 km/h... Gjithashtu, nga llogaritja rezulton se mjeti nuk do të dilte nga trajektorja e kthesës nëse ai do të hynte në kthesë me një shpejtësi më të vogël ose të barabartë me shpejtësinë 15km/h... dhe në rastin konkret shpejtësia e mjetit ka qenë 15-20 km/h”*. Gjithashtu, ai pretendon se sipas aktekspertimit auto-teknik gomat e para të automjetit kanë rezultuar të kenë qenë të konsumuara.

Në vijim, ky shtetas pretendon se ndryshe nga sa ka pranuar gjykata, nga aktet e depozituara nga organi i akuzës para gjykatës është provuar se aksidenti ka ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor (referuar Kodit Rrugor).

3.3 Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit vendimin nr. ***, datë 28.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, ankimin që ka bërë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë kundër këtij vendimi, si dhe certifikatën familjare të datës 1.2.2021.

3.4 Pas analizimit të vendimit, Komisionit i rezultoi se çështja penale është regjistruar në datën 4.5.2021 dhe ka përfunduar së gjykuari në datën 28.7.2021. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 2 muaj e 24 ditë. Referuar vendimit, në fillim me shortin elektronik të datës 4.5.2021 është zgjedhur gjyqtar një subjekt tjetër (F. H.) i cili, me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 14.12.2020, ka vlerësuar arrestimin dhe ka caktuar masën e sigurimit ndaj të pandehurit. Çështja është shortuar dhe në datën 14.5.2021 është caktuar gjyqtar subjekti i rivlerësimit.

⁸⁵Denoncim nr*** prot., datë 7.9.2021.

Në përfundim të gjykimit, organi i akuzës ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit A. B., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290, paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Penal. Në bazë të nenit 290/2 të Kodit Penal është kërkuar dënimi i të pandehurit me 2 (dy) vite burgim. Në bazë të nenit 290/3 të Kodit Penal është kërkuar dënimi me 5 (pesë) vite burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, për bashkimin e dënimeve për disa vepra penale, është kërkuar dënimi përfundimisht i të pandehurit me 6 (gjashtë) vite burgim. Gjithashtu, organi i akuzës i ka kërkuar gjykatës që të mbahet parasysh zhvillimi i gjykimit me ritin e gjykimit të shkurtuar, vuajtja e dënimit të kryhet nga momenti që vendimi të marrë formë të prerë dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurin për një kohë prove sa koha e dënimit përfundimtar me burgim të dhënë nga gjykata, duke detyruar të pandehurin të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës dhe në bazë të nenit 60 të Kodit Penal të mos shoqërohet me persona të dënuar.

3.5 Gjykata, në vendim, ka evidentuar “rrethanat e faktit dhe provat”, ku, ndër të tjera, parashikohen “aktekspertimi auto-teknik i datës 4.12.2020” dhe “aktekspertimi auto-teknik i datës 13.4.2021” referuar nga denoncuesi.

Për “aktekspertimin autoteknik të datës 4.12.2020” citohet qartë në vendim nga gjykata se: *“Shtetasi nën hetim A. B. ka shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, pasi me vetëbesim të tepruar është futur në një vendkalim të rrezikshëm, në një rrugë që nuk plotëson asnjë element sigurie për qarkullimin, duke rrezikuar fillimisht jetën e personave që kishte në makinë...”* dhe për “aktekspertimin autoteknik të datës 13.4.2021” citohet se: *“Gjatë këqyrjes së mjetit u evidentua që të dy gomat e para të mjetit ishin të konsumuara dhe goma e parë e krahut të majtë ishte e shfryrë. Bazuar në gjendjen faktike të mjetit në momentin e aksidentit mjeti nuk ka plotësuar kushtet teknike për të qarkulluar... ka rezultuar se shpejtësia kritike në kthesë është e rendit 15 km/h... Gjithashtu, nga llogaritja rezulton se mjeti nuk do të dilte nga trajektorja e kthesës nëse ai do të hynte në kthesë me një shpejtësi më të vogël ose të barabartë me shpejtësinë 15 km/h. dhe në rastin konkret shpejtësia e mjetit ka qenë e rendit 15-20 km/h...”*.

3.6 Komisioni, referuar “vlerësimit të gjykatës”, vëren se arsyetohet vendimmarrja në raport me konkluzionet e akteve të ekspertimit (duke u fokusuar në mungesën e parametrave të sigurisë rrugore), përgjigjet e dëshmitarëve të ngjarjes dhe të pandehurit dhe në raport me analizën mbi ekzistencën e elementeve të veprës penale dhe “lidhjes shkakësore” midis veprimeve/mosveprimeve dhe pasojave. Gjykata ka arritur në konkluzionin se veprimet e të pandehurit nuk përbëjnë veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar në nenin 290 të Kodit Penal, prandaj, në bazë të nenit 388/b të Kodit të Procedurës Penal duhet të deklarohet i pafajshëm.

Në përfundim, gjykata ka vendosur: *“Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit A. B., i akuzuar për kryerjen e veprës penale ‘shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor’, parashikuar nga neni 290, paragrafi i dytë dhe i tretë i Kodit Penal, sepse fakti nuk përbën vepër penale...”*.

3.7 Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, me shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2021, ka përcjellë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë ankimin kundër vendimit nr. ***, datë 28.7.2021, të kësaj gjykate. Ndër të tjera, organi i akuzës e ka ankimuar vendimin me pretendimin se referuar provave dhe akteve të administruara gjatë hetimeve (aktekspertimeve, dëshmimeve, etj.) ekzistojnë elementet që kërkohen për figurën e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, neni 290 i Kodit Penal. Gjithashtu, ka pretenduar se gjykata, në vendimin e saj, i ka interpretuar provat e administruara në proces në mënyrë të gabuar. Përfundimisht, organi i akuzës ka kërkuar:

- Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 28.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, për deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A. B., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, neni 290, paragrafi i dytë dhe i tretë i Kodit Penal.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit A. B., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, neni 290, paragrafi i dytë dhe i tretë i Kodit Penal dhe dënimin e tij sipas kërkesës së paraqitur në konkluzionet e paraqitura në seancën e diskutimit përfundimtar.

3.8 Për sa më sipër, pa zëvendësuar logjikën e gjyqtarit në vendimmarrje, Komisioni i kërkoj subjektit të jepte shpjegime lidhur me pretendimet e denoncuesit. Gjithashtu, Komisioni i kërkoj subjektit të jepte shpjegime mbi vendimmarrjen e tij në raport me konkluzionet e ekspertëve në aktet e ekspertimit, si dhe në raport me ankimin e organit të akuzës, të qartësonte mbi vijimësinë e statusit të kësaj çështjeje dhe të depozitonte dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve të tij.

3.9 Subjekti, në prapësime, ndër të tjera, ka pretenduar se:

- i) Zgjidhja që i ka dhënë kësaj çështjeje është e drejtë dhe e arsyetuar.
- ii) Organi i akuzës ka qenë i dyzuar në qëndrim, duke vendosur edhe bërjen e riekspertimit.
- iii) Kërkesat lidhen kryesisht me themelin e çështjes. Konkretisht, ai ka pretenduar se “sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të ligjit nr. 84/2016 dhe të praktikës së konsoliduar të Komisionit dhe të Kolegjit, vlerësimi i provave dhe zgjidhja në themel që i bën çështjes një gjyqtar nuk është objekt i vlerësimit kalimtar të kryer nga organet e rivlerësimit”.
- iv) Në gjykimin e tij ai ka konsideruar aktekspertimin në mundësitë dhe hapësirat që lë, duke mos qenë strikt në konkluzione. Pra, thënë ndryshe, subjekti ka konsideruar në këtë vendimmarrje faktin e konkluduar në aktekspertim se shkak për ardhjen e pasojës në humbjen e jetës dhe plagosjen e disa shtetasve ka qenë vetë gjendja dhe cilësia e rrugës, pasi ajo është pa asnjë parametër sigurie.
- v) Shqyrtimi i kësaj çështjeje shtrihet edhe tej periudhës së rivlerësimit.

Lidhur me statusin e çështjes, subjekti ka konfirmuar se ndaj kësaj çështjeje është ushtruar ankim nga organi i akuzës dhe se është ende në pritje të gjykimin. Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti ka referuar faqen elektronike të Gjykatës së Apelit Shkodër www.gjykata.gov.al.

3.10 Subjekti, në mbështetje të pretendimeve, ka depozituar: (i) vendimin nr. ***, datë 10.3.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër, me objekt “zëvendësim mase sigurimi nga arrest me burg në detyrim paraqitjeje”; (ii) konkluzione të organit të akuzës, datë 12.7.2021 (Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë, përfaqësuar nga prokuror P. Ç.), për diskutimin përfundimtar të procedimit penal nr. *** të vitit 2020, përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; (iii) dy akt ekspertime auto-teknike, datë 4.12.2020 dhe datë 13.4.2021; (iv) vendimin për dhënie të pafajësisë, nr. ***, datë 28.7.2021; si dhe (v) printimin nga faqja elektronike e Gjykatës së Apelit Shkodër lidhur me statusin e çështjes (ku rezulton në përpunim).

3.11 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve dhe provave të depozituara, vlerëson se subjekti është ndodhur në kushte preferenciale, për sa kohë aktet e ekspertimit nuk ka qenë maksimalisht konkludent, por kanë pasur hapësira diskutimi. Nga verifikimi i akteve të depozituara vërehet se aktekspertimet realisht janë të dyzuara, duke parashikuar qoftë elemente që e fajësojnë të pandehurin, por edhe elemente që e shfajësojnë atë. Po ashtu, elemente të cilat vlerësohen si domethënëse për këtë proces janë edhe faktet që organi i akuzës ka kërkuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, por edhe fakti i pranimit të zëvendësimit të masës së sigurimit personal.

3.12 Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se në këtë rast nuk mund të zëvendësohet logjika e subjektit në arsyetim. Për më tepër, për sa kohë çështja është ende në gjykim, ligjshmëria e vendimit do të finalizohet në gjykatat e shkallëve më të larta. Për këto arsye kjo çështje nuk mund të ndikojë në vlerësimin profesional të subjektit.

3.13 Për sa u arsyetua më sipër, Komisioni, pas analizimit të denoncimeve, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se në tërësi ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të gurmës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë”.

Vlerësimi tërësor i çështjes

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

a) Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c) Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentian Marku, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, aktualisht i komanduar edhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.1.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta